



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit**

**Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

**STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

TEZA:

**“Poetika e veprës “Pelegrini i vonuar” nga Dritëro  
Agolli”**

**Kandidati:**

**Besartë Arifi**

**Mentor:**

**Prof. dr. Zeqir Kadriu**

**Tetovë,**

**2019**

HYRJE.....	3
Lënda e hulumtimit.....	5
Hipotezat.....	6
Metodologjia e hulumtimit.....	7
Rëndësia e hulumtimit.....	8
JETA DHE VEPRA E DRITËRO AGOLLIT .....	9
Biografia .....	9
Veprimtaria letrare .....	12
LETËRSIA E VITEVE '60.....	14
Agolli dhe Kadare : miq apo rivalë .....	17
PROFILI POETIK I DRITËRO AGOLLIT.....	20
VEPRA POETIKE “PELEGRINI I VONUAR” .....	25
Analizë poezisë “Pelegriini” .....	28
MOTIVET NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT .....	30
Tema e atdheut.....	30
Motivi erotik.....	36
Tema e pleqërisë dhe e vdekjes.....	44
Tema e përmbysjeve politike dhe thyerjeve shpirtërore .....	53
FIGURA E KALIT NË POEZITË E AGOLLIT .....	58
POEZI PËR POEZINË.....	61
NDIKIMI I FILOZOFISË BEKTASHIANE NË VEPRËN “PELEGRINI I VONUAR” .....	64
STRUKTURA RITMIKO – INTONATIVE.....	69
STRUKTURA FIGURATIVE .....	72
PËRFUNDIM .....	79
BIBLIOGRAFIA.....	80

## HYRJE

Objekt i këtij punimi do të jetë vepra poetike "Pelegriini i vonuar" e poetit të mirënjohur bashkëkohor shqiptar Dritëro Agolli, përkatësisht struktura e saj poetike, prandaj që në fillim do të mundohemi ta përcaktojmë kuptimin e nocionit "strukturë".

Togfjalëshi "strukturë e tekstit letrar" paraqet një nga kategoritë themelore të studimit të letërsisë. Termi strukturë ka kuptimin e fjalës ndërtim në gjuhën shqipe dhe paraqet mënyrën e organizimit të një tërësie nga pjesët e saj.

Në këtë punim do të tentohet të paraqiten segmentet kryesore të veprës "Pelegriini i vonuar" të Dritëro Agollit, të sheshohen elementet themelore të këtij libri, të përcaktohet vlera estetike e tij, duke pasur parasysh, gjithmonë, aspektin tematik dhe estetik të poezive të veçanta dhe të librit në tërësi.

Kemi bërë përpjekje që lëndën ta paraqesim duke iu përmbajtur një parimi: të bëhet analiza e drejtpërdrejtë e tekstit të vjershave dhe poemave, kurse në fund të bëhet një sintezë e gjithë punimit, e problemeve dhe rezultateve të tij.

Dritëro Agolli është një autor që mbart me vete një bagazh të madh me krijime të ndryshme letrare. Ai ka eksperimentuar në shumë lloje të veprave letrare qoftë në prozë, poezi apo dramë, ndaj për këtë arsye ka shumë për të lexuar e për të analizuar. Përmbledhjet me poezi zënë vendin më të madh në gjithë krijimtarinë e tij letrare.

Mbi të gjitha përmbledhjet e tij poetike zgjedha "Pelegriini e vonuar", pasi nga studiues dhe kritikë letrarë dallohet si njëri nga vëllimet më të mira të Agollit. Kjo vepër është shkruar gjatë kohës së tranzicionit, kur Shqipëria kaloi nga sistemi komunist në atë demokratik. Kjo periudhë aq e trazuar në vend, e trazoi po aq shpirtërisht autorin, i cili në poezitë e tij shprehu të gjithë trishtimin, të gjitha ndjenjat në lidhje me ndryshimet shoqërore. Poezitë e kësaj përmbledhjeje duke filluar nga "Pelegriini" që është poezia e parë e librit e duke vazhduar me poezitë tjera kanë shumë material që ia vlen të analizohet, shumë shprehje të bukura që ja vlen të dallohen,

për të vazhduar me mjetet artistike që ka përdorur autori që e bëjnë shumë të arrirë këtë përmbledhje poetike.

Poezitë e Dritëro Agollit janë shumë të thella e të ndjera. Nëpërmjet vargjeve të tij ai arrin të bëjë një lidhje me lexuesin, duke prekur tema e motive që e prekin atë. Poezitë me motiv atdhetar ose ato erotik trajtojnë dashurinë ndaj atdheut dhe ndaj gruas në një mënyrë tjetër. Me anë të vargjeve të tij ai na jep një këndvështrim tjetër të gruas e të atdheut, duke e shtyrë lexuesin të shohë atdheun me një sy ndryshe, të dojë çdo pëllëmbë të tij, kurse për gruan ta dojë e ta shohë atë jo vetëm si një njeri, por si një qenie hyjnore që i rri gjithmonë burrit pranë. Një pjesë të mirë të vëllimit zënë edhe poezitë për pleqërinë dhe vdekjen që autori i ka trajtuar në një mënyrë interesante. Duke lexuar poezitë e këtij motivi njihemi me mendimet e Agollit për këto procese të jetës, për mënyrën si do të trajtohet emri ose le të themi figura e tij kur ai të mos ekzistojë fizikisht.

Në këtë punim gjithashtu do të trajtohet edhe aspekti fetar në poezitë e përmbledhjes poetike “Pelegrini i vonuar”. Dritëro Agolli, një ateist, i cili shprehte haptas mosbesimin e tij në forcat e mbinatyreshme, përmend në shumë poezi Zotin, i lutet atij. Kjo përmendje e shpeshtë na shtyn të mendojmë arsyen që e ka çuar autorin që ta bëjë Zotin personazh në shumë nga poezitë e tij, si dhe pse i lutet atij edhe pse nuk i beson.

Përmenda që Agolli ka shkruar lloje të ndryshme letrare, por mbi të gjitha dashuria e tij më e madhe mbetet poezia. Në këtë punim do të analizoj më gjerësisht krijimet kushtuar poezisë, veprës së tij, vargjeve që thurte.

Dritëro Agolli është një poet i veçantë që solli risi në stilin e të shkruarit, duke përdorur figura të ndryshme letrare e duke eksperimentuar me llojet e ndryshme të vargjeve dhe të rimës.

## Lënda e hulumtimit

Në vitet 60' të shekullit XX, autorët shqiptarë u përpoqën të nxjerrin letërsinë nga skemat që kishte vendosur regjimi diktatorial. U bënë hapat e parë për të shkruar lirshëm, për tu ikur skemave realizmi socialist. Poezia u lëvrua më shumë dhe veprat poetike ishin më të shumta. Autorët e kësaj periudhe janë disa nga autorët më të njohur të letërsisë sonë. Ndër të tjerë, në këtë kontekst, mund të përmendim treshen më të njohur të poezisë shqipe: Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapi.

Dritëro Agolli është njëri nga autorët më të njohur shqiptarë i cili bëri bujë me veprimtarinë e tij letrare. Shkrimet e tij të para i përkasin periudhës së realizmit socialist, por nga shumica vlerësohet se ato krijime nuk konsiderohen si të angazhuara, pra nuk i shërbejnë idesë së “madhe” të krijimit të “njeriut të ri”. Poezitë e tij kapin majat e poezisë lirike duke qenë se janë poezi të veçanta, me karakteristika që rrallë i gjejmë jo vetëm te poetët e kohës së tij, por edhe të ditëve të sotme.

Në këtë punim do të ndalemi vetëm në poetikën e veprës “Pelegri i vonuar”, duke analizuar karakteristikat e poezive të kësaj përmbledhjeje, motivet, temat e trajtuara dhe çfarë i bën poezitë e këtij autori kaq të dashura për lexuesin.

## Hipotezat

Agolli dhe një rreth i ngushtë shkrimtarësh, bashkëkohanikë të tij, konsiderohen novatorët në letërsinë shqiptare të realizmit socialist. Cilët janë elementet novatorë të kësaj krijimtari? A është kjo letërsi vërtet novatore në shkallën që të sjellë një përmbysje të madhe në mënyrën e trajtësimit artistik të fenomene dhe dukurive shoqërore dhe jo vetëm?!

Përmbledhja poetike "Pelegri i vonuar" është vepër e vitit 1993 në të cilën shkrimtari si objekt të trajtësimit artistik ka një varg çështjesh, duke filluar nga ato krejtësisht individuale, deri te temat që lidhen me ekzistencën e një kombi. Në të pasqyrohet, ndër të tjera transformimi shpirtëror i shqiptarit si individ dhe si pjesëtar i një kombi. Po ky ndryshim i ngjall shpresë apo dyshim poetit?

Vetë Dritëro Agolli ishte pjesë e nomenklaturës komuniste. Ai ushtronte detyra që nuk përjashtoheshin nga ndikimi shtetëror e ideologjik i asaj kohe. A është nostalgjik autori për kohët që perënduan apo është realist kur konstaton trazimet aq të thella shpirtërore të njerëzve të "kohës së re", të kohës së ndryshimit ?

## Metodologjia e hulumtimit

### Faza përgatitore

- studimi i veprës “Pelegri i vonuar
- formulimi i platformës studimore “Poetika e veprës “Pelegri i vonuar” nga Dritëro Agolli”

### Faza e mbledhjes së të dhënave

- studimi i çdo poezie në veçanti
- studimi i literaturës (kritika dhe analiza të shkruara për veprën e Dritëro Agollit)

### Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

- përqasja me studime të mëparshme
- analiza të thelluara mbi poezitë në përgjithësi, motivet dhe temat
- përgjithësime dhe përfundime

### Metodologjia e kërkimit

Në bazë të qëllimit të punimit, metodologjia e kërkimit mbështetet në poezitë e Dritëro Agollit.

Poezitë analizohen secila në veçanti dhe arrihet përfundimi.

## Rëndësia e hulumtimit

Dritëro Agolli është një autor shumë me vlera në letërsinë tonë. Poezia e tij edhe pse është analizuar dhe komentuar shumë, gjithmonë ka diçka të re për të diskutuar. Shumë studiues kanë folur e shkruar mbi poezinë e Agollit dhe vlerat e saj.

Vepra “Pelegri i vonuar është njëra nga kryeveprat e tij. E shkruar pas 25 viteve, nga vepra e parë e Dritëroit , kjo vepër paraqet gjithë arritjen e autorit brenda atyre viteve. U botua pas ndërrimit të sistemit shoqëror në Shqipëri. Duke lexuar poezitë e këtij vëllimi, lexuesi mendon se a ndihet Agolli nostalgjik për sistemin e mëparshëm apo është i lumtur që ka mbaruar dhe është i gatshëm për një jetë të re, me një sistem të ri.

Në poezitë e Agollit vërejmë një vazhdimësi, gjë që kuptohet nga vetë titulli “Pelegri i vonuar”, që na përkujton shtegtimin e tij poetik, ndryshimet që ka pësuar që nga fillimet e tij si poet. Tani është një kohë tjetër kur kanë ndodhur shumë ngjarje tronditëse, ka pasur përmbysje shoqërore dhe poeti shprehet ndryshe.

Agolli është një “pelegrin” i cili është në kërkim të paqes shpirtërore dhe kërkon një fije shprese për të gjetur rrugën e duhur.

Në këtë punim magjistrature do të analizohen të gjitha këto ndjesi të autorit, çfarë ka dashur ai të thotë në poezitë e tij, si është ndjerë për përmbysjet politike, ndryshimet e kohës, ngjarjet tronditëse që kishin ndodhur.



# JETA DHE VEPRA E DRITËRO AGOLLIT

## Biografia

Dritëro Agolli lindi në fshatin Menkulas të Devollit, në vitin 1931. Atje kaloi fëmijërinë, kujtimet e së cilës i mbetën të gjalla dhe ia përcolli edhe lexuesit, më vonë, në krijimtarinë e tij letrare. Si i vogël ka qenë një djalë çapkën dhe gjatë një interviste tregon se si është larguar nga shtëpia për tu bashkuar me partizanët gjatë Luftës Nacional-çlirimtare. Duke qenë se në atë kohë ishte vetëm 14 vjeç ata nuk e pranuan në çetë, por e angazhuan si korrier për shpërndarjen e letrave dhe të trakteve.

Në vendlindje kreu shkollën fillore, më pas u zhvendos në qytezën e Bilishtit ku u shkollua një periudhë të shkurtër. Gjimnazin e kreu në Gjirokastër, pasi ishte një qytet më i madh dhe i ofronte kushte më të mira duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të asaj kohe. Ai mësoi në gjimnazin “Asim Zeneli”, që dallohej atëherë për kualitetin e mësimnxënies dhe mësimdhënies. Duke qenë se ishte shumë i dhënë pas kafshëve, ai ishte shumë i interesuar për veterinarinë si degë, madje ishte i vendosur që në jetën e tij profesionale do tu përkushtohej kafshëve dhe do të punonte si veteriner. Një tjetër arsye për këtë vendim ishte edhe “vdekja” e kalit të tij, një kujtim ky nga fëmijëria që e kishte prekur shumë, prandaj ai donte të kujdesej për të gjitha kafshët. Por për arsye se ai që i ri ishte marrë me poezi dhe krijimet e tij ishin lexuar edhe nga ministri i arsimit të asaj kohe Karaman Ylli, iu caktua nga shteti që nuk do të studionte për veterinarin, por për letërsi. Studimet e larta i vazhdoi në Shën Petersburg të Rusisë, që atë kohë njihej si Leningrad, qytet ky ku ishte foleja e studentëve shqiptarë. Shumica e të rinjve që vazhdonin shkollimin drejtoheshin pikërisht në këtë qytet, ku ndër të tjerë mund të përmendim edhe Ismail Kadarenë. Si temë diplome, ai zgjodhi të punonte Migjenin, të fliste për vlerat e tij si autor, dhe të tregonte vendin e rëndësishëm që ka zënë në letërsinë shqipe. Këtë temë, Dritëroi e punoi me udhëheqjen e njëres prej albanologeve më të shquara Agnia Desnickaja.

Pas 5 vite qëndrim në Bashkimin Sovjetik, Agolli u rikthye në atdhe, për tu vendosur në Tiranë, ku jetoi dhe punoi gjatë gjithë jetës. Për 15 vite ka punuar si gazetar në “Zëri i popullit”.

Profesioni i gazetarit ka ndikuar shumë në krijimtarinë e tij. Ky profesion kërkon kontakt me shumë njerëz, merr informacione të ndryshme, dëgjon ngjarje nga më të ndryshmet. Të gjitha këto kanë qenë frymëzim për autorin, që personazhet e ngjarjeve që botonte në artikujt e tij, pse jo t'i paraqiste edhe në poezitë e tij, duke qenë se ato vinin nga realiteti, nga jeta e përditshme e shqiptarëve, ishin ngjarjet që njerëzit i përjetonin çdo ditë.

Nga viti 1974 deri më 1991-1992 ishte në postin e kryetarit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, vite këto të cilat autori i konsideron si më të rreptat gjatë gjithë periudhës së komunizmit në Shqipëri. Pra këtë post Agolli e mbajti për 19 vite, edhe pse fillimisht hezitoi ta pranonte, pasi ndihej mirë në profesionin e gazetarit dhe nuk dëshironte të kishte përgjegjësi më të mëdha. Por Komiteti Qendror i Partisë Komuniste kishte vendosur që pikërisht Dritëroi ishte njeriu i duhur për këtë post. Mirëpo kjo çështje nuk ka qenë aspak e lehtë për të. Dimë se gjatë kohës së regjimit komunist shumë autorë që ngrinin zërin ndaj pushtetit komunist burgoseshin, vriteshin ose internoheshin. Për këtë arsye Dritëro Agolli është akuzuar shpesh herë se ka pasur gisht në dënimin e disidentëve dhe autorëve të ndryshëm të kohës. Në një intervistë të dhënë më 2009 Agolli mohon kategorikisht pjesëmarrjen në vendimet për disidentët, madje shton se Lidhja e merrte vesh shumë vonë fatin e ndonjë autori të tillë.

Përveç letërsisë Agolli u mor edhe me politikë, ku për 30 vite ka qenë deputet në Kuvendin e Shqipërisë, në legjislatura të ndryshme, qoftë në komunizëm, qoftë në demokraci.

Periudha e studimeve në Shën Petersburg, përveç mësimave ishte e mbushur edhe me aventura rinore. Gjatë qëndrimit atje Dritëroi u takua me një vajzë ruse . Vajzën në fjalë Agolli e mori me vete kur u kthye në atdhe, ku edhe kurorëzuan dashurinë e tyre, si dhe fryt i dashurisë ishte edhe një djalë të cilin Agolli e pagëzoi me emrin ilir Arian. Mirëpo kjo martesë nuk do të zgjaste shumë për arsye të prishjes të marrëdhënieve mes Shqipërisë komuniste e Bashkimit Sovjetik. Konflikti mes dy vendeve solli ndarjen e shumë çifteve, ku një ndër ta ishin edhe Dritëroi me gruan e tij ruse. Ishte autori ai i cili vendosi ti japë fund martesës duke menduar më hollësisht pasojat që mund të kishte nga vazhdimi i martesës. Vajzat ruse të martuara me shqiptarë në atë kohë burgoseshin, internoheshin ose vriteshin duke u konsideruar si spiune të

Bashkimit Sovjetik, dhe jo rrallë nga kjo gjë pësonte edhe bashkëshorti. Pikërisht kjo ishte arsyeja e prishjes së martesës mes tyre. Edhe pse u nda prej saj ai nuk e harroi djalin e tij, i cili ishte 7 vjeç kur u nda nga i ati. Kaluan 28 vite që prej asaj dite që Agolli të takonte përsëri djalin e tij, i cili ruante akoma kujtimet nga koha që kishte jetuar në Shqipëri, madje mbante mend pak edhe gjuhën shqipe që ia kishte mësuar i ati.

Dritëro Agolli u martua për së dyti kur ishte 34 vjeç. Por si erdhi deri te kjo martesë? Agolli ishte pjesëmarrës në shumë takime letrare, ku i ra në sy Sadija, një vajzë e re dhe e bukur shkodrane. Martesa e Ismail Kadaresë me Elenën më 1964 ishte momenti ku Dritëroi dhe Sadija u njohën më mirë, falë ndërmjetësimit të Elenës. Ata u martuan në vitin 1965.

Sadija ishte dashuria e jetës së Dritëroit. Ajo është një nga figurat më të rëndësishme në jetën e tij, dhe jo më kot i ka kushtuar një pjesë të mirë të krijimtarisë së tij, duke e shprehur dashurinë e madhe ndaj saj me anë të vargjeve, pasi si poet ajo ishte mënyra më e mirë për të shprehur atë që kishte në zemër e mirënjohjen për mbështetjen e madhe që i jepte ajo.

Për sa i përket besimit, është një çështje që autori e ka diskutuar shpesh si dhe haptas me publikun. Ai thekson shpesh se është ateist dhe nuk beson në një forcë të mbinatyrshme, pra në Zot. Ky besim i tij mund të lidhet me komunizmin, duke qenë se Dritëro Agolli nuk e moho faktin që ka qenë një i tillë dhe i ka shërbyer pushtetit, edhe pse mund ta ketë kritikuar. Dimë se komunizmi nuk e lejon besimin fetar, dhe gjatë asaj periudhe në Shqipëri janë djegur kishat edhe xhamitë. Ky mund të ketë qenë një nga faktorët kryesorë që Agolli të marrë një vendim të tillë për të qenë ateist, si dhe për ta shprehur haptas qëndrimin e tij. Por edhe pse jo besimtar, në shumë poezi të Agollit përmendet Zoti, ose Perëndia, qoftë edhe librat e shenjtë.

Agolli jetoi deri në fund të jetës në Tiranë, në të njëjtin apartament pa ndërruar adresën, një apartament ky i vogël në Rrugën e Dibrës. Për fat të keq me kalimin e kohës gjendja e tij shëndetësore sa vinte dhe rëndohej shkaku i një sëmundjeje në mushkëri. Pak para vdekjes qëndroi disa dite i shtrirë në spital. Dritëro Agolli vdiq më 3 shkurt 2017, në moshën 85 vjeçare duke i shkaktuar letërsisë dhe artit shqiptar humbjen më të madhe, humbjen e një kolosi, e një figure të pazëvendësueshme në letërsinë tonë.

## Veprimtaria letrare

Dritëro Agolli është njëri nga autorët shqiptarë i cili njihet për llojllojshmërinë e krijimtarisë letrare, duke botuar shumë vepra, në zhanre të ndryshme letrare.

Edhe pse Agollit në shpirt i fle poezia, kjo nuk do të thotë që ai nuk u mor me lloje të tjera letrare si p.sh tregime, novela, drama, romane, shkrime humoristike-satirike, artikuj kritikë, vështrime dhe ese etj. Pra ai ishte poet, prozator, dramaturg, eseist, publicist, kritik, ai provoi të gjitha zhanret e shkrimit, duke korrur sukses pothuajse në të gjitha llojet.

Përveç veprave të shkruara vetë, ai ka sjellë para lexuesit edhe përkthimet të disa veprave më të mira të letërsisë botërore, nga autorët më të njohur të huaj siç janë : Jesenini, Majakovski, Lorca, Elyari, Bagricki, Robert Bërns, Uollt Uitman etj. (Vinca, 2010: 140). Në veprën “Pelegrini i vonuar” gjenden 6 vjersha të përkthyer nga autorë të huaj. Në pjesën e dytë të librit “Psherëtimat e vjeshtës”, poezi të përkthyer janë këto : “Ujku plak” (Agolli,1998: 152) nga Ivashkeviçi, “Rëndësia” (Agolli,1998: 153) nga M. Karem dhe “Përroi” (Agolli,1998: 157) nga A. Lundkvist. Kurse në pjesën e fundit të veprës “Tingujt e maleve” gjejmë edhe tri poezi të tjera të përkthyer, ato janë dy poezi nga autorët e njohur rus “Nëna ime” (Agolli,1998: 210) nga F. Sollogub, “Ne të dy” (Agolli,1998: 212) nga Cvetajeva si dhe poezia “Dy trupa” (Agolli,1998: 214) nga Balmonti.

Në arenën ndërkombëtare u bë i njohur pikërisht me veprat e tij në prozë, veçanërisht me romanin e tij satirik “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”. Ky roman është përkthyer në 22 gjuhë të botës. Së fundmi ky roman u përkthye edhe në gjuhën turke.

Veprat letrare:

- PROZË (romane, drama, tregime) :
  - **Zhurma e erërave të dikurshme , tregime, (1964)**
  - **Komisari Memo, roman (1969)**
  - **Njeriu me top, roman (1975)**
  - **Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo, roman (1973)**

- *Njeriu i mirë (tregime) (1973)*
- *Trëndafili në gotë, roman (1980)*
- *Fytyra e dytë (dramë) (1968)*
- *Mosha e bardhë (dramë) (1975)*
- *Baladë për një grua (dramë) (1980)*
- *Dështaku, roman (1991)*
- *Njerëz të krisur, tregime e novela (1995)*
- *Kalorësi lakuriq, roman (1996)*
- *Arka e djallit, roman (1997)*

- POEZI:

- *Në rrugë dola (1958)*
- *-Hapat e mia në asfalt (1961)*
- *Shtigje malesh dhe trotuare (1965)*
- *Mesditë (1969)*
- *Pleshti (1971)*
- *Nënë Shqipëri (1974)*
- *Fjala gdhend gurin (1977)*
- *Dhjetë sy (1985)*
- *Udhëtoj i menduar (1985)*
- *Pelegri i vonuar (1993)*
- *Çudira dhe marrëzi (1995)*
- *Lypësi i kohës (1995)*
- *Shpirti i gjyshërve, 101 këngë (1996)*
- *Vjen njeriu i çuditshëm (1996)*
- *Baladë për tim atë dhe për vete (1997)*
- *Fletorka e mesnatës (1998)*
- *Këmbana e largët (1998)*

- *Gdhihet e ngryset (2000)*
- *I përndjekuri i dashurisë (2013)*
- *Prit edhe pak (2016)*
- *E bukura, lozonjarja, tokësorja Grua (2017)*

Kur shohim listën e veprave të botuara nga Agolli, vërehet qartë se mjeshtëria e tij ka qenë poezia, pikërisht për këtë arsye numri më i madh i veprave të botuara janë në poezi. Pas Ismail Kadaresë, Agolli është autori shqiptar më i lexuar dhe më i përkthyer.

## **LETËRSIA E VITEVE '60**

Hapat e parë të poezisë bashkëkohore u bënë pas Luftës Nacional-çlirimtare, pikërisht në periudhën e realizmit socialist. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, në vitet 1944-45 në Shqipëri u vendos një sistem i ri, ai komunist. Në krye të pushtetit u vendos Partia Komuniste Shqiptare në krye me Enver Hoxhën, e cila vuri monopol në të gjitha fushat e jetës. Vitet e para të këtij regjimi ishin më të buta dhe letërsia frymonte më lirshëm. Me egërsimin e regjimit në vitet '50, edhe liria e të shprehurit u kufizua. Në këtë periudhë pati shumë autorë të cilët shkruanin në bazë të skemave të pushtetit diktatorial, duke folur më shumë për luftë ose edhe për pushtetin e atëhershëm, duke i lartësuar figurat e asaj kohe, duke himnizuar luftën kundër fashistëve, ose pushtetin komunist. Krijimtaria e shkruar në këtë kohë u quajt si letërsi e angazhuar pasi autorët nuk kishin lirinë të shpreheshin në mënyrën që ata donin. Periudha e realizmit socialist nuk ka qenë një nga periudhat më të përshtatshme për autorët shqiptarë, që ato të shprehen lirshëm dhe të shkruajnë atë që e mendojnë. Me instalimin e diktaturës komuniste, u vendosën edhe skemat jashtë të cilave shkrimtarët nuk mund të shkruanin, ndryshe do të kishin pasoja, si burgosje, internime dhe jo rrallë edhe dënime me vdekje. Ideja liberale ishte e ndaluar në veprat e asaj kohe dhe autorët e asaj kohe ishin të detyruar që tu përmbahen me fanatizëm skemës së realizmit socialist, të vendosur nga pushteti diktatorial i

asaj kohe. Shumë autorë të cilët nuk e pranonin skematizmin, dhe ngritën zërin për fjalën e lirë e pësuan pasi u burgosën, u vranë ose u arratisën, siç ishin : Arshi Pipa, Kasëm Trebeshina, Lame Kodra (Sejfulla Maleshova), Trifun Xhagjika, Zef Zorba, Federik Rreshpja, Bilal Xhaferi etj.

Në gjysmën e dytë të viteve 1950, në skenën letrare shqiptare dolën një varg krijuesish të rinj e të talentuar si Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Fatos Arapi, Din Mehmeti, Azem Shkreli, Dhimitër Shuteriqi etj. Edhe pse shkrimet e para dhe librat e tyre të parë këto krijues i botuan kah fundi i viteve '50 apo më herët, afirmimin e tyre të plotë e arritën më vonë, gjatë viteve '60 e këtej, atëherë kur letërsia shqipe shënon një rritje cilësore, rritje kjo që u atribuohet, sidomos, disa poetëve të lartpërmendur. Këto autorë ishin të parët që u përpoqën të dalin nga skematizmi i letërsisë, duke krijuar vepra letrare mjaft cilësore, me një stil të palëvruar më parë, që e bëri lexuesin për vete. *Gjatë kësaj dekade u shfaqën dhe u kristalizuan tiparet ideoartistike të një tendence të re dhe të veçantë stilistike – tiparet e poezisë novatore dhe realiste lirike* (Vinca, 1985: 197)

*Zgjerimi i horizontit tematik dhe stilistik, pasurimi i fondit të shprehjes dhe teknikës krijuese, trajtimi organik i temës shoqërore dhe intime etj. ishin vetëm disa nga karakteristikat ideoartistike të poezisë shqipe të kësaj kohe.* (Vinca, 1985: 105) . Përveç vargut të lirë që ishte një risi në letërsinë realiste të asaj kohe, e veçanta dhe ndryshimi më i madh qëndronte te personazhet, te heronjtë lirikë të veprave. Nëse para viteve '50, tema kryesore ishte lufta Nacional-çlirimtare, partizanët, njerëzit më me emër të asaj kohe, në letërsinë novatore të brezit të ri, heronj lirikë ishin njerëzit e thjeshtë. Pra në këtë periudhë vërejmë një lidhje të poezisë me njeriun. Duke qenë se ky i fundit është personazh kryesor në poezitë e asaj kohe, lexuesit ishin më të interesuar dhe i ndjenin më shumë poezitë për shkak se temat që trajtoheshin merreshin nga jeta e tyre, nga përditshmëria. Poezia e viteve 60 ishte shumë realiste gjë që e bënte atë më të kapshme dhe më të ndjerë për lexuesit. *Poezinë e lind jeta, tronditjet e saj, bëmat, përjetimet e brendshme, aspiratat.* (Shaplllo, 1990: 6). Poezia është një mjet për të shprehur gjendjen shpirtërore, jo vetëm të poetit por edhe të gjithë shoqërisë. Këtë gjë dinin ta bënin fare mirë autorët që shkruan në këtë periudhë, duke arritur të prekin tema reale, të arrijnë skutat më të thella të shpirtit të njeriut.

Ishte kjo periudhë kur u bënë hapat e parë drejt novatorizmit dhe në letërsi u futën elemente të reja. Autorët që botuan në këtë periudhë devijuan nga tradita, gjë që solli një konflikt mes autorëve të vjetër që donin të përmbaheshin akoma mënyrës së të shkruarit të mëparshëm dhe brezit të ri të cilët shkruanin në mënyrë të re, trajtonin ngjarjet në formë tjetër në veprat e tyre. Pra autorët që shkruan në këtë periudhë, duke dalë jashtë skemave të përcaktuara nga pushteti, duke lënë anash traditën, dhe duke përqafuar një stil të ri shkrimi, sollën konfliktin midis së resë dhe së vjetrës, që u diskutua shumë në atë kohë, nëpërmjet artikujve dhe studimeve të shumta që u botuan atë kohë për këtë çështje. Edhe pse në përpjekje për të sjellë risi në letërsinë tonë, ata nuk e lanë anash letërsinë popullore, duke e gërshetuar atë me shumë mjeshtri me krijimtarinë e tyre, por gjithsesi duke mbetur originalë dhe duke e ruajtur individualitetin. Në fillim të viteve 1960, në të përjavshmen “Drita”, Dritëro Agolli botoi një artikull me titull “Traditë, natyrisht, por jo shtampë”, ku fliste se letërsia shqipe ka nevojë për një frymë të re. Ai nuk ishte kundër traditës, por ishte kundër monotonisë që kishte përshkruar atë kohë letërsinë tonë, ku vetëm lartësoheshin heronjtë e luftës, jepej një imazh i rremë i asaj periudhe. Ky artikull e ndezi debatin mes brezit të pas luftës dhe brezit të ri që ishin të prirë drejt një letërsie novatore. Agolli kritikon mënyrën e të shkruarit, pothuajse të njëjtë të të gjithë autorët, gjithashtu edhe personazhet të cilët ai i quan të pakapshëm, njerëz jorealë dhe vetëm me veti të mira. Sipas Agollit një hero lirik duhet të ketë ndjenja, mendime, duhet të ketë anët e tij pozitive dhe negative.

Kjo letërsia e re, mund ta quajmë, u zhvillua si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë. Por kulmin më të madh e arritën Ismail Kadare, Dritëro Agolli dhe Fatos Arapi. Ata hapën horizonte të reja krijuese duke shkruar një letërsi me shumë vlera artistike. Këta të tre autorë përbëjnë trekëndëshin më të rëndësishëm të letërsisë sonë, duke kapur majat dhe duke korrur suksese jo vetëm brenda kufijve të shtetit shqiptarë por edhe në botë, duke u përkthyer në dhjetra gjuhë të botës, si dhe duke marrë çmime të rëndësishme ndërkombëtare. Kjo treshe luajti rolin vendimtar për zhvillimin e letërsisë shqipe, duke e nxjerrë atë nga kornizat që i kishte vendosur pushteti diktatorial.



## Agolli dhe Kadare : miq apo rivalë

Përmenda që Agolli dhe Kadare janë dy nga autorët më të mirë të gjithë letërsisë bashkëkohore shqiptare. Në rininë e tyre kanë qenë miq të mirë, njiheshin që në shkollë, **studiu**an që të dy në Leningrad (Shën Petersburgu i sotëm) në Rusisë. Edhe në martesën e Kadaresë, ishte miku i tij Dritëro që ishte pranë tij. Sidomos pas vitit 1957, kur Agolli u kthye nga Bashkimi Sovjetik, ata ishin miq mjaft të mirë, që diskutonin shumë në lidhje me letërsinë ose tematika të ndryshme lidhur me kohën e atëhershme. Gjithsesi edhe pse miq të mirë në jetë, letërsia i bëri rivalë njëri me tjetrin. Për një kohë të gjatë lexuesi shqiptar ka qenë në një debat të zjarrtë : Kadare apo Agolli? Shumë herë është bërë pyetja se cili është ai që mban primatin e letërsisë shqipe, por përgjigjet kanë anuar herë nga njëri herë nga tjetri. Vlen të theksohet që pavarësisht “betejës” me njeri-tjetrin, të dy autorët kanë mbajtur një qëndrim për sa i përket kësaj teme, duke mos u përfshirë në debate njëri me tjetrin, duke e lënë kështu lexuesin të zgjedhë vetë se kush është më i miri. Në një intervistë ku është pyetur në lidhje me kandidaturën për çmimin Nobel, Agolli është shprehur që Kadareja është i vetmi autor shqiptar që e meriton këtë çmim, duke treguar kështu konsideratën që kishte për Kadarenë si autor. Kanë qenë studiues e kritikë, ata të cilët kanë hapur këtë debat, ndoshta për të qenë vetë në qendër të vëmendjes, e jo vetë autorët në fjalë. Gjithashtu Agolli i pyetur shpesh nëpër intervista në lidhje me Kadarenë, ka mohuar të kenë kontradikta ose marrëdhënie të acaruar mes njëri-tjetrit. I vetmi shkak për diskutim mes tyre shprehet që kanë qenë debatet mbi letërsinë e tij, ku Agolli si udhëheqës i Lidhjes së Shkrimtarëve ishte i detyruar të kritikonte ose me një fjalë të këshillonte Kadarenë për mënyrën e të shkruarit.

Për mendimin tim të dy autorët kanë karakteristikat e tyre që i bëjnë të veçantë dhe i vendosin në majat e letërsisë sonë. Përkundër dallimeve mes njëri-tjetrit ata i kanë meritat e përbashkëta për atë që i dhanë letërsisë shqipe, e jo vetëm. Gjithashtu që të dy patën guximin të ngrejnin zërin për fjalën e lirë duke refuzuar letërsinë e angazhuar, dhe duke krijuar vepra shumë cilësore që e ngrinin lartë letërsinë shqipe. Kadareja u përqendrua më shumë në prozë duke botuar romane me tematika të ndryshme, kurse nga ana tjetër Agolli u mor më shumë me

poezi. Gjithsesi dy autorët lëvruan edhe prozën edhe poezinë, edhe lëmi të tjera të letërsisë ku korrën shumë sukses.

Ismail Kadare, autor gjirokastrit tashmë i njohur në mbarë botën për veprën e tij. Fakti që ka qenë kandidat për çmimin Nobel tregon për cilësinë e veprave të tij dhe talentin e tij si krijues. Kadare filloi krijimtarinë e tij letrare që i ri, kur studionte në Rusi. Siç e përmendëm më lart ishin vitet 60 kur ai bashkë me autorë të tjerë filluan të dalin nga skematizmi dhe të shkruajnë për tema të cilat ishin të ndaluara atë kohë nga pushteti. Nëse lexojmë një përmbledhje me poezi ose qoftë një roman të këtij autori dallojmë menjëherë praninë e mitit, e figurave të ndryshme mitologjike. Kadareja është një autor i cili ka marrë shumë nga letërsia popullore, nga mitologjia shqiptare, si personazhe ashtu edhe motive. Për shembull legjendën e Doruntinës e të Konstandinit, atë të Gjergj Elez Alisë ose edhe të tjera mund t'i lexojmë sipas variantit të Kadaresë, një variant shumë origjinal dhe tërheqës që e plotëson legjendën, shton detaje të tjera duke nxitur edhe më shumë imagjinatën e lexuesit. Përfshirja e miteve dhe personazheve mitologjikë e legjendarë në veprimtarinë e tij krijuese është diçka shumë e rëndësishme sepse në këtë mënyrë këto vlera të popullit tonë ruhen dhe përcillen brez pas brezi.

Kadareja shquhet më së shumti për romanet e tij, ku mund të përmendim : “Kështjella”, “Prilli i thyer”, “Kronikë në gur”, “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, “Lulet e ftohta të marsit”, “Kush e solli Doruntinën”, “Dimri i vetmisë së madhe”, “Dosja H” etj. Këto janë disa nga romanet e tij më të njohura, të përkthyer deri diku në 50 gjuhë të huaja. Për sa i përket poezisë, ky autor ka shkruar poezi të bukura si për atdheun, ose dashurinë të cilat i ka përmbledhur në veprat : “Përse mendohen këto male”, “Motive me diell” etj.

Sipas vlerësimit të lexuesit, primatin e prozës bashkëkohore shqipe e mban Kadareja me romanet e tij, kurse për poezi më të arrira shquhet Agolli. Që të dy autorët në llojin e tyre zënë vendin kryesor në letërsinë tonë.

Dritëro Agollin dhe Ismail Kadarenë i bashkon atdheu, dashuria dhe vlerësimi që kanë për të. Edhe pse shpesh kanë kritikuar shqiptarët për çështje të caktuara, para botës ata kanë ditur të nxjerrin anën më të mirë të vendit tonë. Falë Kadaresë bota njihet me mitologjinë e pasur shqiptare, me figura të veçanta që nuk i ka asnjë popull tjetër, me karakteristikat që i bëjnë

shqiptarët të veçantë si besa, mikpritja, doket dhe zakonet e ndryshme për jetën e vdekjen, pra me të gjitha vlerat e kombit tonë. Nga ana tjetër falë Agollit, ne e shohim ndryshe atdheun tonë, duke lexuar poezitë e tij kuptojmë se sa i bukur është atdheu ynë, sa e dashur është toka jonë të cilën duhet ta punojmë e të nxjerrim prej saj frytet, falë tij ne njohim bujkun e bariun shqiptar, punëtorin shqiptar i cili çdo ditë jep për atdheun e për tokën e tij. *Ismail Kadare e krijoi {Shqipërinë tjetër} duke mërguar në lashtësinë e moçme shqiptare, ndërsa {Shqipëria tjetër} e Dritëro Agollit, që hyjnizohet tek “Nënë Shqipëri” dhe në vepra tjera, është kulti i atdheut, përthirja e krenarisë kombëtare.* (Sinani,2002: 135) Këto dy autorë, pavarësisht stilit të ndryshëm të të shkruarit, temave të ndryshme që kanë trajtuar në veprimtarinë e tyre letrare, sërish na kthejnë me sytë nga atdheu ynë, duke na bërë të kuptojmë vlerën e vërtetë të tij, gjithashtu vlerën e jetës sonë. Dritëro Agolli dhe Ismail Kadare, mund të kenë pasur rivalitetin mes tyre, por pa marrë parasysh atë, ata janë dy autorët më të mëdhenj të letërsisë sonë, duke i dhënë aq shumë asaj, si dhe duke e ngritur lart para botës emrin Shqipëri, këtë vend të vogël që bota e ka nënçmuar shpesh.

## PROFILI POETIK I DRITËRO AGOLLIT

Dritëro Agolli është njëri nga këta krijues që me krijimtarinë e tij poetike i dha një cytje të re poezisë shqipe dhe e bëri të njohur veten në skenën letrare shqipe, por edhe më gjerë.

Kontakti i parë i Agollit me letërsinë ka qenë si fëmijë, edhe atë nëpërmjet folklorit, duke qenë se kur ai ishte fëmijë ishin shumë aktuale përmbledhjet “Visaret e kombit” ku gjendej e gjithë pasuria folklorike e të gjithë zonave të Shqipërisë. Përveç kësaj ai mësonte në shkollë poezitë e Naim Frashërit ose edhe të Ndre Mjedës të cilat e tërhiqnin shumë dhe do të bëheshin frymëzim i tij gjatë rrugëtimit letrar. Agolli është shprehur se edhe fshatarët në Menkulas ishin të dhënë pas letërsisë dhe dinin poezi të ndryshme të letërsisë botërore, të cilat i kishin mësuar nga mërgimtarët që ishin kthyer në atdhe pas shumë viteve endje në rrugët e botës. Të gjitha këto e formësuan dashurinë dhe dëshirën e Agollit për letërsinë. Si nxënës dhe si student ai shpesh botonte poezi ose edhe artikuj të ndryshëm në revistat letrare për të rinj, ose merrte pjesë në takime letrare që organizonin të rinjtë asaj kohe.

Krijimtarinë e tij Agolli e ka nisur qysh në mesin e viteve '50. Në këtë periudhë temat në letërsi trajtoheshin bardhë e zi dhe gjuha e të shkruarit ishte e varfër. Agolli ishte njëri nga autorët që iu shmang këtyre formave të vjetra të shkrimit për të sjellë në letërsinë tonë një frymë të re, si dhe duke u bërë kështu një model i zhvillimit të letërsisë për autorët që do të vinin pas tij, gjithashtu një krijues i traditës së letrare në letërsinë tonë. *Agolli gjithashtu është një person kyç i letërsisë shqipe të pasluftës së dytë botërore dhe për faktin se ai mori pjesë, qoftë aktivisht, qoftë indirekt në krijimin e politikave (teknikave) krijuese, qoftë në nivelet brenda komunitetit letrar, qoftë në nivelet e politikave letrare shtetërore* (Osdautaj, 2011: 10). Ai i dhuroi lexuesit një poezi jo tradicionale, siç kishin servirur autorët tjerë të realizmit socialist, një poezi e cila nuk himnizonte heronjtë e luftës, por heronjtë e përditshmërisë si bujkun e bariun, fshatarin e studentin, malësorin dhe intelektualin. Letërsia para viteve '60 ishte e përfshirë nga një *monumentalizëm i gënjeshtërt*, siç shprehet Shaban Sinani, e ishte Agolli dhe bashkëkohësit e tij që e hoqën këtë frymë nga letërsia jonë. Një vepër e cila u diskutua shumë si edhe u ndalua për tu lexuar ishte “Zhurma e erërave të dikurshme” që autori e shkroi më 1964. Në këtë vepër

vihet re dalja nga tradita dhe hyrja në letërsinë e re. Në këtë vepër autori paraqet disa kontradikta për sa i përket Luftës Nacional-çlirimtare, pra nuk lëvdon ose himnizon atë luftë, por thotë disa të vërteta me të cilat pushteti nuk ishte i kënaqur prandaj edhe e ndaloi.

Poezia e tij solli risi jo vetëm kur bëhej fjalë për heronjtë lirikë, por edhe në mënyrën e të shkruarit, mjetet shprehëse dhe formën artistike në përgjithësi.

Që në hapat e parë të krijimtarisë së tij u vërejt aftësia dhe talenti i tij për të shkruar, aftësi kjo që rritej e zhvillohej pas çdo përmbledhjeje me poezi që ai e botonte. Që nga përmbledhja e parë e tij me poezi, personaliteti i tij poetik do të vijë duke u formuar, kurse tiparet e stilit dhe të shprehjes së tij poetike duke u kristalizuar. Poezinë e Agollit e përshkon larmishmëria e temave, motiveve dhe personazheve të ndryshëm, ku lexuesi mund të gjejë veten. Te ajo gjejmë një mori temash dhe motivesh dhe mjetesh shprehëse.

*Poezia e Agollit është e qartë, e thjeshtë dhe e bukur; asociative dhe sugjestive. Dhe mbi të gjitha tejet e hapur dhe komunikative.* (Vinca,2010: 159). Ky autor njihet si njëri nga më komunikativët, më të dashurit për tu lexuar, pasi poezitë e tij i ngjajnë një bisede të qetë e të përzemërt me lexuesin. Nëpërmjet poezive të tij ai ka krijuar një lidhje afërsie me lexuesin, duke e bërë poezinë e tij tërheqëse për ta lexuar dhe më të ndjerë. *Agolli s'ka pushuar së qeni një poet mjaft popullor, që s'mban kurrfarë distance me lexuesin e thjeshtë; që dhimbjen, gëzimin dhe dobësinë njerëzore i merr si ndjenja universale dhe i shkrin me filozofinë jetësore* (Sinani,2002: 135)

Përveç kësaj, poezia e Agollit karakterizohet edhe nga novatorizmi, risia që solli ai në letërsinë shqipe si dhe temat antiskematike të cilat nuk gjendeshin në veprat e botuara më parë nga autorë të tjerë shqiptarë. Sipas studiuesit Murteza Osdautaj, poezia e këtij autori është shumë piktoreske dhe vizuale, pra autori shkruan në atë mënyrë që lexuesi mund të vizualizojë në mendjen e tij atë që e lexon. Në shumë poezi të tij është e pranishme dhe forma e peizazhit që jep të njëjtin efekt te lexuesi.

*Agolli do të fillojë dhe do të vazhdojë të jetë poet i emocioneve themelore njerëzore.* (Osdautaj,2011: 19). Poezia e Dritëro Agollit del para lexuesit si poezi që ushqehet nga

shqetësimet dhe hallet e përditshme të njerëzve, nga meditimet dhe dramet e tyre shpirtërore. Ajo shquhet për realizëm në pasqyrimin me shprehje poetike të transformimeve shoqërore, jetës njerëzore, të natyrës, denoncimit të dukurive negative në shoqëri etj. Për këtë arsye poezia e tij ka qenë konkrete dhe shumë realiste, pasi ai nuk i ka dashur zmadhimet ose zbukurimet e panevojshme në poezi. Agolli dallohet nga poetët e tjerë për nga qartësia që e përshkon poezinë e tij, thjeshtësia. Në poezitë e tij vërejmë një harmoni midis vargjeve dhe realitetit, botës njerëzore. Shumë studiues e quajnë atë poet të filozofisë dhe të dhimbjes njerëzore sepse ka ditur të paraqesë shumë mirë botën e brendshme, shpirtëroren të njerëzve duke e gërshetuar atë në mënyrë artistike dhe me shumë mjeshtri edhe me pamjen e jashtme (siç bën shpesh te poezitë me motiv erotik ose ato të peizazhit).

Humori është shpesh pjesë e poezive të Dritëro Agollit. Ai me vargjet e tij të përshkuara nga notat e humorit godet dukuri të cilat nuk i duken të pëlqyeshme. Me anë të humorit ai vë në lojë pushtetin por shpesh edhe fenë duke marrë parasysh faktin që ai nuk ishte vetë besimtar.

Frymëzimi është një nga gjërat më të rëndësishme për një krijues. Jeta e përditshme, dukuritë dhe gjërat që na rrethojnë janë burim frymëzimi për shumë autorë. Dritëroi ishte njeri dashamirës, kishte një natyrë të dashur dhe të hapur. Ai ishte gjithmonë në lëvizje, dhe nuk preferonte ta shkruante poezinë në studion e apartamentit të tij, por jashtë në hapësirë, pikërisht atje ku gjente edhe frymëzimin. *Në një rast, me humorin e tij karakteristik, ai thotë se poezia e madhe nuk shkruhet “me këmbë në legen” por duke ecur e bredhur, kurse motivet e poezisë janë si vajzat lozonjare, të cilat po si ndoqe pas të ikin e të lënë duarthatë.* (Vinca,2004: 153). Ai përfshinte në poezitë e tij çdo gjë që i kapte syri si në rutinën e tij të përditshme në vendin ku jetonte, si në udhëtimet e tij të gjata në kërkim të frymëzimit. Siç thamë ai nuk kishte një natyrë të mbyllur, prandaj edhe në poezitë e tij gjejmë ngrohtësinë dhe njerëzoren. Gjatë udhëtimeve të tij ai afrohej me njerëz, bisedonte me ta, merrte prej tyre material për poezitë e tij. Pra njerëzit që takonte ishin njëri prej burimeve të frymëzimit të tij për të shkruar. *Në rrugë duke ecur e bredhur vazhdimisht, poeti e gjen frymëzimin, i gjen heronjtë dhe motivet e poezisë, sepse, siç thotë në vjershën e shkurtër lirike “Motivet”, ato – motivet, janë si vajzat lozonjare, që po si ndoqe pas, të ikin e të lënë.* (Vinca,2010: 144). Natyra ishte një burim frymëzimi për

autorin, elemente të saj gjejmë shpesh në poezitë e autorit, gjejmë livadhet e përrenjtë, malet etj. të cilat autori do t'i ketë edhe varr pasi të ndërrojë jetë. Me mjeshtërinë e tij autori vendos një harmoni mes poezisë dhe natyrës. Duke vendosur këtë harmoni ai paraqet edhe një peizazh që me anë të përshkrimit mjaft artistik vetë lexuesi mund ta parafytyrojë në mendjen e tij. E njëjta ndodh edhe me portretet e njerëzve.

Si një burim i pashtershëm frymëzimi për shumë autorë, si dhe për Agollin në këtë rast, janë kujtimet e fëmijërisë. Siç dimë, Dritëroi ka lindur në Devoll, një fshat pranë qyteti të Korçës, dhe ka përjetuar jetën e fshatit. Si fëmijë ai është lidhur me kafshët, me bujqit, me barinjtë, pra me të gjitha karakteristikat që ka jeta e fshatit. Të gjitha këto lanë mbresa në mendjen e autorit dhe e ndoqën atë gjatë gjithë jetës së tij, prandaj këto kujtime e përjetime ai ia përcjell lexuesit nëpërmjet poezive të tij.

Shpesh autorët ndikohen edhe nga poetë të njohur të letërsisë për të shkruar. Idhulli i Agollit nga autorët e letërsisë shqipe, ishte autori më i njohur i Rilindjes Kombëtare, Naim Frashëri. Profili poetik i Dritëroit është i përafërt me atë të Naimit. Në vargjet e te dyve gjejmë gjëra të njëjta p.sh atdheun me bukuritë e tij, baltën e vendlindjes, plisin, fshatarin e lidhur me tokën, shtigjet e maleve, fushat, njerëzit, zakonet e tyre etj. Në shumë vargje të tij ndihet panteizmi naimian si dhe paraqitet një Shqipëri utopike siç e shohim edhe në poezitë e Naim Frashërit. Autor tjetër që ka frymëzuar autorin është Lasgush Poradeci, edhe ai i njohur për dashurinë ndaj natyrës, ndaj peizazhit mahnitës që ofronte qyteti i vogël i Pogradecit e liqeni i bukur i Ohrit. Që të dy autorët i karakterizon dashuria për natyrën, për vendin e lindjes, si dhe pikëtakimi mes tyre është filozofia dhe dhimbja njerëzore. Te të dy autorët vërejmë ngjashmëri të mënyra se si e trajtojnë njeriun, si dhe sa shfrytëzojnë natyrën për të treguar gjendjen shpirtërore të njeriut, dhimbjet e gëzimin e tij. Nga autorë të huaj, mund të veçojmë si frymëzim për Agollin, Robert Bërn, poet skocez i njohur për poezitë e tij. Gjithashtu Agollit u ndikua mjaft edhe nga autorët rusë që vepruan dhe krijuan gjatë shekullit XX. Fakti që jetoi në Rusi për disa vite për të studiuar, si dhe lidhja miqësore mes Ruisë dhe Shqipërisë, bëri që letërsia ruse të lexohej mjaft nga autori, si dhe të bëhej edhe frymëzim për të.

Përveç autorëve të tjerë, si frymëzim për autorin është edhe vetë letërsia e krijuar nga populli. Dimë që shqiptarët kanë një letërsi popullore shumë të pasur me këngë, balada, legjenda të cilat paraqesin një burim të vërtetë frymëzimi për autorët. Në poezitë e këtij autori vërehet ndikimi i poezisë popullore. Agolli me aftësinë e tij krijuese, ka ditur të përfshijë këtë letërsi në krijimtarinë e tij. Karakteristikat e letërsisë popullore, poeti i ka gërshetuar në vargjet e tij, por në një mënyrë bashkëkohore, duke e bërë edhe poezinë e tij jo tradicionale por në fakt shumë origjinale, novatore dhe me individualitet të theksuar. Agolli ka shkruar në një poezinë popullore e atë realiste duke i dhuruar lexuesit një poezi shumë cilësore.

Në gjithë krijimtarinë letrare të Agollit gjejmë lidhjen e tij të ngushtë me njeriun dhe jetën. Njeriu i thjeshtë është heroi lirik ose ndryshe quajtur subjekti lirik në shumë poezi të Agollit. Më shumë se njerëzit e mëdhenj, që kanë bërë heroizma të vërteta, që kanë luftuar ose janë lartësuar nga të tjerët, Dritëroi himnizon njeriun, atë që punon tokën, që kullot bagëtitë çdo ditë, që punon në fabrika etj., që bën punë të ndryshme për të jetuar. Këtë njeri poeti e ndjen të afërt, e ndjen si mikun e shokun e tij të jetës. Duke e bërë pjesë të krijimtarisë së tij, ai e bën njeriun e thjeshtë të përjetshëm dhe lartëson punën që bën ai çdo ditë. Çdo njeri mund ta gjejë veten e tij në poezitë e Agollit. Nëpërmjet heroit lirik autori shpreh edhe ndjenjat e tij për çështje të ndryshme shoqërore që ndodhnin në atë kohë. Nga e gjithë kjo kuptojmë se , *Agolli është poet i këndimit për njeriun e thjeshtë, për botën e tij, për dhembjen dhe gëzimin, për kraajat jetësore dhe për përpjekjen e përgjithmonshme për të jetuar.* (Osdautaj, 2011: 32)

Teknika e krijimit të artit të Dritëro Agollit nvalet pra e gjitha nga njeriu dhe natyra. Ai është një autor i cili bukurinë e frymëzimit e gjen në gjërat që e rrethojnë, te njerëzit që shikon e takon çdo ditë, te jeta dhe vdekja, pra në gjëra të vërteta që janë pjesë e njeriut, duke lënë anash gjërat madhështore, të pakapshme për mendjen njerëzore. Sipas poetit vetë jeta është burimi i të gjitha temave, motiveve që pasqyrohen në poezitë e tij.

*Bashkë me Ismail Kadare dhe me disa krijues të tjerë, kryesisht më të rinj, Dritëro Agollit është një prej poetëve tanë relativisht të rrallë bashkëkohorë, që thuaja rregullisht është kujdesur t'i njoftojë lexuesit e vet me pikëpamjet dhe konceptet e tij për poezinë apo letërsinë në përgjithësi, duke shkruar e botuar krahas vjershave, poemave, tregimeve, novelave, romaneve, dramave*



*dhe shkrimeve humoristike-satirike, edhe artikuj kritikë dhe ese për probleme të ndryshme të artit dhe të letërsisë* (Vinca, 1985: 120). Ai ishte një poet novator që sillte risi në letërsinë tonë, ndaj gjithmonë i dilte në mbrojtje kësaj poezie të re që ai dhe bashkëkohësit e tij kishin krijuar, duke dalë kështu nga skemat që i kishte vënë poezisë pushteti i atëhershëm. Në poezitë e tij Agolli tregonte realitetin, pa e zbukuruar atë, pa shtuar gjëra të panevojshme, prandaj kjo e tërhiqte edhe më shumë lexuesin.

Nga gjithë analiza që mund ti bëjmë në përgjithësi krijimtarisë letrare të Agollit dalim në përfundim se vendlindja, toka, buka, natyra, familja janë kult për të. Edhe pse në poezi me motive të ndryshme ai gjen një farë mënyre që të përshijë këto elemente duke treguar kështu se çfarë rëndësie kanë ata për të, po edhe për njeriun në përgjithësi, pasi e lumturojnë njeriun i japin jetë dhe shpresë për të ardhmen.

## **VEPRA POETIKE “PELEGRINI I VONUAR”**

Në vitin 1985, Dritëro Agolli botoi vëllimin “Udhëtoj i menduar”, vëllim ky që pasqyronte rritjen artistike të këtij krijuesi dhe u prit shumë mirë nga lexuesit. Në këtë vëllim flitet për shqetësimet e njeriut, për jetën në përgjithësi, por nuk lihen pas dore detajet e vogla që na rrethojnë që e bëjnë jetën më të bukur. Në këtë vëllim veç anën kuptimore, vërehet një ndryshim si në përdorimin e figurave, e të vargjeve duke sjellë kështu ndryshim në stilin e të shkruarit. Kjo vepër do të vendosë bazat e një krijimtarie më cilësore të autorit. Fill pas kësaj ai do të botojë veprën e tij më të njohur “Pelegri i vonuar” më 1993. Ky vëllim me poezi është mjaft voluminoz, përmban 256 faqe, dhe gjithsej 217 poezi.

Vepra është e përbërë nga tri pjesë. Pjesa e parë mban titullin “Dhimbjët e karvanit” dhe në të përfshihen poezitë e krijuara në kohën e tranzicionit. Pjesa e dytë titullohet “Psherëtimat e vjeshtës”, ndërsa pjesa e tretë “Tingujt e maleve”.

Është një periudhë kohore 25 vjeçare që ndan botimin e përmbledhjes së parë “ Në rrugë dola” nga botimi i vëllimit “Pelegri i vonuar”. Për këto 25 vjet të krijimtarisë së tij poetike janë bërë

ndryshime të dukshme shoqërore dhe si pasojë e kësaj kanë ndryshuar edhe mendimet, ndjenjat, idetë dhe mënyra e qasjes së problemeve nga ana e tij. Vjershat e këtij vëllimi na hapin një kapitull të ri të jetës së autorit, si dhe të luftës së popullit tonë për të mbijetuar. Poezia e Agollit është poezi novatore, prandaj botimi i çdo libri nga ky autor paraqet një eveniment të rëndësishëm për lexuesin shqiptar.

“Pelegri i vonuar” është një nga librat më të rëndësishëm të lirikës shqipe. Ky është libri i parë i këtij autori i botuar pas ndërrimit të sistemit shoqëror në Shqipëri. Ishte kjo kur ky vend përjetoi një ndryshim të madh shoqëror. Dalja nga komunizmi, i cili qe aq i rreptë, dhe hyrja në një sistem të ri, të lirë patjetër që do të pasqyrohej edhe në poezi. Gjithsesi periudha e tranzicionit ishte një rrëmujë e vërtetë. Pas 50 vite nën regjim, nuk ishte edhe aq i lehtë pranimi i diçkaje të re. Edhe pse njerëzit e kishin kërkuar demokracinë përsëri ishte e vështirë të fillohej çdo gjë nga e para, të caktoheshin rregulla të reja. Kjo rrëmujë e madhe e prekte thellë poetin, gjë që e shpreh edhe në poezitë e këtij vëllimi, ku vihet re fare mirë trishtimi, dhimbja për shoqërinë e asaj kohe, për gjendjen e mjerueshme në të cilën ndodhej Shqipëria.

Duke ecur në gjurmët e poezisë së vet më të mirë, të një lirike meditative që e ka pasur kurdoherë, që doli në pah te vëllimi “Udhëtoj i menduar”, Dritëro Agolli ruan stilin e vet, e shpie atë më përpara në formë, në varg, dhe mbi të gjitha me kërkime në përmbajtje, duke shprehur kohën, dramën e saj dhe përjetimet e veta në këtë realitet. Poezia e Agollit e ruan kontinuitetin. Kjo gjë vihet re qysh në titullin e përmbledhjes, titull ky që na sugjeron se motivi i rrugës, i shtegtit poetik do të jetë i pranishëm edhe në këtë vëllim, ashtu siç ishte te shumica e librave të mëparshëm.

Pelegri janë njerëz që të shtyrë nga besimi i tyre i madh nisen në udhëtime të gjata për të shkuar në vende të shenjta. Agolli është vetë një i tillë, por ai nuk udhëton për në vendet e shenjta por vetë krijimtaria e tij është një shtegtim i gjatë i tij. Ai për vite të tëra do të shtegtojë nga njëra gjini letrare në tjetrën, pasi ai ka prekur pothuajse të gjitha zhanret letrare, ka shkruar poezi, poema, novela, tregime, romane, drama, ese, skenarë filmash, publicistikë. Në krijimtarinë e tij Dritëro Agolli shtegton në hapësirë dhe kohë, si dhe në histori. Ai trajton tema të ndryshme në poezitë e tij, ka heronj lirikë të ndryshëm, shtegton nga fshati në qytet, nga

bujku tek një intelektual. Udhëtimi si motiv përshkon pothuajse të gjithë krijimtarinë letrare të këtij poeti. Përveç titullit të përmbledhjes poetike “Pelegri i vonuar”, shtegtimin ose udhëtimin e gjejmë në disa tituj të tjerë të Agollit si për shembull : “Në rrugë dola”, Hapat e mia në asfalt, Shtigje malesh dhe trotuaresh etj. apo edhe nga titujt e disa vjershave dhe poemave të veçanta: “ Në udhëtim”, “Poema e udhës”, “Duke udhëtuar në male”, “Duke udhëtuar anës detit”, “Unë dhe Shkumbini” etj. *Nuk është e vështirë të konstatohet se udhëtimi(shtegtimi) është bërë për poetin një nevojë organike dhe një parakusht për krijimtari shpirtërore, në ç’gjë ka ndikuar me siguri edhe profesioni i gazetarit, të cilin ky poet e ushtroi vite me radhë.* (Vinca,1985 : 140). Udhëtimi ose rrugëtimi që përmendet kaq shpesh në krijimtarinë letrare të Agollit nënkupton udhëtimin e tij në rrugën artistike, hapat drejt majave të letërsisë sonë, pra i gjithë ky rrugëtim çon në rritjen e tij artistike.

Meqë “Pelegri i vonuar” është një vëllim poetik i botuar pas viteve 90, në vitin 1993 më saktësisht, pra pas rënies së komunizmit, në të vërehen elementë të ndryshëm nga më parë. Këto elementë njihen si metafizikë, dhe janë: vdekja, dhimbja, vuajtja, humbja, dëshpërimi etj. Këto dukuri që në pamje të parë shkaktojnë efekt negativ te lexuesi, janë motiv në një numër të madh të poezive të kësaj përmbledhjeje. Fakti që janë aq të pranishëm në poezitë e Agollit, tregojnë se kanë qenë ndjenja që kanë pushtuar shpirtin e mendjen e poetit. Me anë të këtyre poezive lexuesit dhe studiuesit kuptojnë gjendjen shpirtërore të autorit, mendimet e ndjenjat e tij të shkaktuara nga ky tranzicion, kalimi nga një sistem në tjetrin, dhe gjendja e shoqërisë në atë kohë. Poezitë e këtij vëllimi janë shkruar pa asnjë lloj kushtëzimi, pa pasur frikën se pushteti do ta ndalojë këtë libër. Me veprën “Pelegri i vonuar” mund të themi se Agolli ka rilindur edhe një herë poetikisht, *me rilindjen e tij poetike, shprehu dhimbjen e një brezi me ideal të shembur, që duhej t’i gjente kuptim të ri jetës dhe vdekjes.* (Sinani, 2012: 81)

## Analizë poezisë “Pelegrini”

Poezia “Pelegrini” është poezia e parë në vëllimin “Pelegrini i vonuar”, prej saj edhe ka marrë titullin ky vëllim poetik, për këtë arsye, është e rëndësishme të analizohet në veçanti, duke u dalluar paksa nga poezitë e tjera.

Kjo poezi është shkruar në tetor të vitit 1991 nga Agolli, pra dy vite para se të botohet ky libër., dhe përbëhet nga 4 strofë.

Pas periudhës së regjimit komunist, autori ndjente nevojën e një ringjalljeje poetike, ai ishte gjithmonë në kërkim të frymëzimit, ishte një pelegrin i cili gjendej gjithmonë duke udhëtuar për të gjetur “karvanin e tij” pra të gjejë qetësinë e tij shpirtërore, vendin e tij në poezi.

Poezinë e fillon me këto vargje :

*Unë jam prej kohësh pelegrin*

*Udhëtar në vendin e shpresës së thyer (Agolli, 1998: 7)*

Nga këto vargje ai e shpreh drejt mendimin e tij, se është gjithmonë në lëvizje në kërkim të diçkaje të shenjtë, ashtu siç bëjnë pelegrinët e besimeve të ndryshme që enden për të shkuar në vendet e shenjta përkatëse. Por në fakt autori bën pelegrinazhin e tij në një vend të pashpresë ku nuk shikon asnjë dritë në fund të tunelit. Shqipëria në periudhën e tranzicionit ishte në një gjendje të mjerueshme, dhe nuk kishte aspak shpresë për rregullimin e gjendjes në vend. Ky fakt e lëndonte autorin shpirtërisht, duke e bërë të ndjejë dhimbje për situatën në të cilën ndodhej populli shqiptar.

Në strofën e dytë të poezisë ai është në kërkim të karvanit të tij:

*Kërkoj karvanin tim në rërë e në shpat*

*Karvanin që e ka ndërruar drejtimin me kohë*

*Ndaj në udhë jam krejt i humbur jam fillikat*

*Me shami të grisur lidhur në kokë (Agolli, 1998: 7)*

Në këtë rrëmujë, autori ndihet kaq i vetmuar, pa ditur ndonjë rrugëdalje, pa ditur të gjejë një shteg drejt “karvanit” të tij. Gjithë kjo e ka shkatërruar e lënduar poetin, e gjendjen e tij e shpreh në vargun e fundit të strofës së mësipërme.

Etja, lodhja, shterja e lotit që i përmend në strofën e tretë tregojnë se autori është i dërrmuar si fizikisht si shpirtërisht. Pavarësisht kohës, pengesave, ai duhet të gjejë patjetër karvanin e tij të humbur.

Në strofën e katërt të poezisë përsërit vargjet e strofës së parë, për të theksuar më mirë atë që do të shprehë :

*Unë jam prej kohësh pelegrin*

*Shtegtar i karvanit të humbur*

*Dhe bart në kurriz një premtim*

*Të dhënë në hirin e gjyshërve të mundur (Agolli, 1998: 7)*

Vërejmë që përmenden dy terme edhe “pelegrin” edhe “shtegtar”, që të asociojnë në udhëtimin, në rrugën e gjatë drejt një destinacioni, një qëllimi ose të një misioni le të themi të cilin do ta përmbushë autori.

Atij i duket se kolegët e tij kanë lënë të vetëm në këtë shtegtim. Madje edhe ai vetë nuk është i sigurt se cila do të jetë rruga e tij e mëtutjeshme artistike. Ai ndjen se ka mbetur vetëm, por megjithatë nuk jepet.

## MOTIVET NË POEZINË E DRITËRO AGOLLIT

Në krijimtarinë letrare të Dritëro Agollit gjejmë motive dhe tema të larmishme. Ai është një autor me horizont mjaft të gjerë, ka prekur tema të shumta, duke shkruar për çdo gjë që lidhet me jetën e njeriun, duke filluar nga gjërat më të thjeshta e deri te ato më të ndërlikuarat. Motivet e në poezitë e këtij autori janë marrë nga jeta e përditshme, nga momente që ndoshta nuk na duken aq interesante, por në fakt janë aq detaje të rëndësishme që e mbushin jetën tonë. Në poezinë e Dritëro Agollit hasen: *tema e luftës dhe e revolucionit, tema e tokës dhe e atdheut, tema e natyrës dhe e dashurisë, tema e punës dhe e transformimeve socialiste të vendit, tema e luftës për emancipimin e gruas dhe e luftës kundër kanunit, tema e luftës kundër mentalitetit mikroborgjez dhe në përgjithësi e marrëdhënieve etiko-morale, tema e fshatit, e vendlindjes dhe e fëmijërisë etj* (Vinca,2010: 157). Shumë prej temave të lartpërmendura i gjejmë edhe në përmbledhjen poetike “Pelegrini i vonuar” . Disa nga motivet e temat më të shpeshta në këtë vepër janë tema e atdheut, dashuria, pleqëria dhe vdekja, figura e kalit (natyre e kafshët) etj.

### Tema e atdheut

Nga të gjitha llojet e ndjenjave njerëzore, ndjenja e dashurisë për atdheun është ndjenjë që më së shumti trajtësohet artistikisht në poezitë e Dritëro Agollit. Kjo tematikë në veprën “Pelegrini i vonuar” shtjellohet në një mënyrë tejet origjinale dhe të veçantë. Historia e popullit tonë ndër shekuj dhe fati tragjik i tij kanë bërë që shkrimtarët tanë më në zë, krijimet e tyre më të arrira t’ja dedikojnë atdheut dhe popullit të vet.

Agolli është një autor i lidhur ngushtë me atdheun, lidhje këtë që e vërejmë në shumë nga poezitë e tij të kësaj përmbledhjeje. Ai është poet me karakter thellësisht kombëtar e popullor dhe këtë e arrin, sepse në radhë të parë është patriot e pastaj poet, edhe pse atij mund t’i bëhen vërejtje të arsyeshme nga kritikë dhe adhurues të poezisë së tij për mungesën e vjershave që do t’i kushtoheshin Kosovës.

*Lirika atdhetare e Agollit, sikurse e tërë poezia e tij është e thjeshtë e konkrete, gjuha e saj është e çliruar nga metaforat e stisura e bërtitëse, ndërsa kur merret me aktualitetin merr ngjyrim grotesk e ironik.* (Vinca, 2004: 153). Ky autor di ta shprehë dashurinë për atdheun jo me eufori, duke ngritur zërin ose qoftë edhe me revoltë për të kaluarën e këtij populli. Ai gjithmonë ndalet në detaje aq të vogla ku ai gjen vetë dashurinë për Shqipërinë, si jeta e thjeshtë fshatareske, natyra e qetë, kafshët, për të arritur deri te figurat që kanë dhënë shumë për atdheun.

Heronjtë lirikë të poezive të Agollit janë patriotë dhe e duan atdheun e tyre, traditat e kulturën shqiptare. I tillë është heroi lirik i poemthit “Trëndafilat e turkeshës”, poemth ky që mbase është krijuar mbi bazën e një detaji në dukje të parëndësishëm, por që imagjinata krijuese e artistit të madh e ka bërë që ta rrëmbejë lexuesin me lirizmin e saj.

Përkujtimi i disa figurave historike që lidhen me kohën e pushtimit turk dhe disa ngjarjeve me rëndësi të po kësaj periudhe bëhet në saje të një bashkëbisedimi polemizues në mes turkeshës dhe heroit lirik, përkatësisht poetit. Këtu përmenden figura si Naim Frashëri dhe vëllezërit e tij Abdylë e Samiu, arkitekt Sinani, Tiko Kapedani si dhe flet edhe për periudhën kur turqit i trembeshin Krujës, duke ditur mirë se atje do të thyheshin gjithmonë nga shqiptarët në krye me Skënderbeun.

Turkesha e re dhe e bukur e mburr poetin Orhan Veli dhe tallet me heroin lirik, i cili nga ana e tij, duke çmuar lart poezinë e Veliut vë në dukje edhe vlerat e letërsisë sonë kombëtare :

*Ti zë qesh e thua prapë : “Ka poetë Arnaut stani” ?*

*Të përgjigjem: “Kish poetë që kur priste jatagani.*

*Në Stamboll nën jataganin ngrinte këngë e ligjërime*

*Një sulltan i poezisë, “Naim beu i tokës sime” (Agolli, 1998: 166)*

Në poemth, në mënyrë mjeshtërore, është paraqitur odisejada e popullit shqiptar në pesë shekujt e sundimit turk, përpjekjet për liri dhe për gjuhë amtare. Është paraqitur gjithashtu edhe vitaliteti i popullit tonë, i cili edhe në ato momente të vështira të historisë së tij, arriti të nxjerrë nga gjiri i vet figura të tilla të ndritura si ajo e Skënderbeut, vëllezërve Frashëri, arkitekt

Sinanit, Zylyftar Podës, Tiko Papajanit e shumë e shumë të tjerë, që çojnë lart emrin e shqiptarit. Jo pa qëllim është futur në krijim edhe emri i Krujës – simbol i qëndresës sonë kombëtare. Atmosferën e nderë të këtij bashkëbisedimi do ta zbusin dhe do ta bëjnë më tërheqëse për lexuesin vargjet popullore të futura mjeshtërisht në brendinë e poemthit:

*Zylyftar mustaqeverdhë*

*Prit nizamët se tu derdhë* (Agolli.1998: 170)

Si dhe :

*Në vapor u ça kazani*

*Humbi Tiko Kapedani*

*Thonë u mbyt e thonë u shua*

*Lëreni dhe mos e ngani*

*Po mahnitet dhe Stambolli*

*Kur del Tikua nga vapori*

*Në një shkëmb qëndron i gjori*

*Shokët deti i shkretë i mori* (Agolli,1998: 173)

Gjuha, tipari kryesor i identitetit kombëtar të një populli, do të bëhet shpesh objekt frymëzimi në vargjet e poetit Dritëro Agolli, ndërsa problemi i mallit ndaj gjuhës është motivi kryesor i vjershës “Poçari” të shkruar në Stamboll. Kjo është njëra nga poezitë më të njohura të Dritëro Agollit dhe nga më të dashurat për gjithë lexuesit.

Me një mjeshtri të rrallë krijuese poeti do të portretizojë botën e brendshme, dramën shpirtërore, ndjenjën e dashurisë ndaj gjuhës dhe vendit të një bashkatdhetari tonë, në



momentin kur ai fare rastësisht mëson se personi që pa dashur thyen poçin në dyqanin e tij sjell gjuhën amtare, pra është njeri i gjakut të tij.

Ndjenjat e poçarit shqiptar në momentin kur ai ndien fjalën shqipe, qoftë ajo edhe fjalë fyese, sharje, poeti na i sjell nëpërmjet vargjeve të realizuara mjeshtërisht:

*Pa më shau poçari keq turqisht*

*Unë e shava shqip e mend i rash*

*Për çudi poçari nuk u ligisht*

*Veç dy lot në sytë e kuq i pashë*

*Për çudi poçari nuk u ligisht* (Agolli,1998: 164)

Autori ndërlidh shumë bukur dashurinë ndaj atdheut dhe gjuhës së nënës. Që të dyja dashuritë janë të pandara me njëra-tjetrën. në vargjet e poezisë më shumë shprehet dashuria për gjuhën, për mallin që ka njeriu qoftë edhe për një fjalë fyese nga gjuha e nënës. Meqë poçari tregohet aq nostalgjik për gjuhën e nënës, rrjedhimisht ai ndjen mall edhe për atdheun e tij. Edhe pse nuk tregohet dashuria ndaj vendlindjes në mënyrë të drejtpërdrejtë, kjo gjë kuptohet nga mënyra e të shprehurit për gjuhën shqipe.

*“Psherëtiu si unë: “Jam shqiptar”*

*Shqip vëlla ti shamë dhe një herë,*

*Fjala shqipe s’blihet në pazar,*

*Në dyqan ka vjet që se kam ndjerë,”* (Agolli,1998: 164)

Vargu i tretë i kësaj strofe është shumë i fuqishëm, duke treguar rëndësinë e fjalës shqipe, gjë nënkupton se për autorin gjuha jonë është e bukur dhe e veçantë.

Atdheut do t’i këndojë bukur Agolli edhe në vjershën me titull “Një gur a një trung”, duke filluar atë me fjalët mjaft dinamike dhe të rrëmbyeshme:

*E dua pa mend vendin tim* (Agolli,1998: 24)

Ai tregon për sakrificat e tij për atdheun, duke shprehur kështu nga njëra anë edhe dashurinë e tij për të. Gjithsesi autori nuk ndjen një moment paqeje, nuk gjen qetësinë në vendin e tij. Kjo lidhet me kohën kur autori e ka shkruar poezinë, që është pikërisht vitit 1991, koha e tranzicionit kur siç dimë Shqipëria sapo kishte dalë nga sistemi komunist dhe në vend mbizotëronte një kaos. Ky fakt se zbeh aspak dashurinë e poetit për vendin e tij.

Dhe për të mos ulur intensitetin e shkallës së arrirë deri në vargun e fundit, kur poeti disi i zemëruar ankohet se:

*Dhe prapë s'gjej një gurë e një trung,*

*Ku të ulem i qetë në agim a në muzg...* (Agolli,1998: 24)

Në mënyrë tjetër shprehet dashuria ndaj atdheut në disa vjersha të tjera, të Agollit si :”Në Monparnas”, “Kur vjen vjeshta” etj., në të cilat motivi i atdheut lidhet me motivin e dashurisë për vendlindjen. Në të parën, nga një largësi e madhe, nga lagja Monparnas në Paris, mendja i vete te fshati i tij i lindjes, në Menkulas, të cilin e vë krahëpër krah me lagjen Monparnas, ku banon elita intelektuale franceze dhe evropiane. Me anë të rimës ai bën një krahasim shumë të bukur mes këtyre dy vendeve, që në fakt u përkasin dy botëve të ndryshme. Monparnasi një zonë në Francë, vend i zhvilluar, i bukur, kurse Menkulasi një fshati i vogël brenda një vendi të vogël, ku nuk kishte as elitë as lukset e jetës franceze, por në fakt jetohej një jetë e qetë, duke punuar në arë ose me bagëtitë. Dallimi mes tyre është i madh, por në luksin që të ofronte Monparnasi, autori ndjente mallin për Menkulasin, për vendlindjen e tij, për të gjithë gjërat që e karakterizonin jetën në fshatin e tij. Këtë gjë e shpreh mjeshtërisht në vargjet e fundit të kësaj poezie:

*“Ah Rotondua” ime mes lajthish*

*Menkulas me brigje poezish*

*Ku kompjuter kemi një këndes*

*Që jep orën herët në mëngjes”* (Agolli,1998: 162)

Ndërsa në vjershën “Kur vjen vjeshta” edhe një herë shprehjet lidhja emocionale e poetit me “tokë-arë buke”. Heroi lirik i kësaj poezie është i shpërngulur në qytet, por dashuria për vendlindjen për jetën në fshat nuk e lë të qetë. Nëpërmjet heroit lirik autori shpreh ndjenjat e tij lidhur me fshatin e lindjes, tregon një jetë aq të begatë atje, sidomos me ardhjen e vjeshtës kur fshatarët vjelin gjithë frytin e punës gjatë vitit.

*“S’më zë gjumi këtej nga qyteti*

*Mua birin e fshatit të dhimbshëm*

*Sikur vreshta pa mbledhur më mbeti*

*Sikur mollët dhe dardhat mu prishën*

*S’më zë gjumi këtej nga qyteti”* (Agolli,1998: 123)

Përsëritja e të njëjtit varg edhe në fillim edhe në fund të strofës tregon trazimin shpirtëror të poetit, tregon për faktin që ai nuk ndjen paqe larg vendlindjes së tij. Element tjetër që tregon lidhjen e ngushtë të poetit është edhe vargu i dytë, ku poeti e quan veten e tij “bir i fshatit”.

Toka e vendlindjes është vendi ku autori do të prehet përgjithmonë. Këtë dëshirë e shpreh në poezinë “Testamenti”, ku i drejtohet tokës së vendlindjes, që të kujdeset për varrin e tij. Autori e donte shumë natyrën, qetësinë shpirtërore që i falte ajo, prandaj do që edhe pas vdekjes të pushojë përjetësisht në vendlindjen e tij të cilën e deshi aq shumë.

*“O toka ime që të lërova e të thura këngë*

*Që ta kam dashur plisin dhe barin*

*Që të kam fshirë me duar dhe mëngë*

*Në ç’vend ma le varrin?”* (Agolli,1998: 185)

Lirikat atdhetare të Dritëro Agollit janë novatore. Në to vërehet një tjetër mënyrë të shprehuri të dashurisë ndaj atdheut. Agolli kishte idhull rilindasit tanë, sidomos Naimin i cili ka thurur vargjet më të bukura për Shqipërinë. Por Agolli edhe pse u frymëzua nga ai, trajtoi dashurinë

ndaj atdheut në një mënyrë novatore. Ai gjithashtu ishte kundër lirikave atdhetare të poetëve të pas Luftës Nacional-çlirimtare që flisnin vetëm për trimëri, për luftë, duke treguar në atë mënyrë dashurinë e atdheut. Agolli zgjodhi një mënyrë tjetër, ai nuk fliste vetëm për ata që luftuan me pushkë për atdheun, ai lartëson ata që punojnë çdo ditë për atdheun, i japin çdo gjë nga vetja tyre. Ai nuk i këndon vetëm atdheut si nocion, por çdo gjëje që i përket atdheut, tokës, fushave, maleve, si dhe fjalës së bukur shqipe, historisë e traditës sonë.

## Motivi erotik

Vjershat për gruan dhe dashurinë në këtë vëllim janë të pakta, hiq disa këngë të botuara në ciklin e tretë, të cilat janë këngë popullore të përshtatura nga autori. Kjo nuk do të thotë se Dritëro Agolli ka shkruar vjersha të dobëta për gruan dhe dashurinë, përkundrazi vjershat e tij të këtij motivi zënë një vend të rëndësishëm në krijimtarinë e këtij poeti. Gruaja që personifikon bukurinë dhe brishtësinë njerëzore konceptohet te ai në mënyrë tokësore, që do të thotë në mënyrë thellësisht shqiptare dhe popullore. *Objekt adhurimi në lirikën e Agollit nuk është gruaja e salloneve mondane, por gruaja e thjeshtë fshatare, ekuivalentin e së cilës e gjejmë te "mikja" e Çajupit dhe te "Ilërëpërveshura" e poezisë popullore.* (Vinca,2004: 154)

Mungesa e poezive me karakter erotik në këtë përmbledhje është e kuptueshme kur kemi parasysh moshën e shtyrë të poetit, i cili në vjershën "Ftohja" deklaroi se vërtet ka humbur të ritë, por zemër merr kur i do ende gratë. Pra mund të heqë dorë nga shumë gjëra të tjera që kalojnë me moshën, por për gratë nuk do të ndërrojë kurrë mendim, gjë që e shpreh në këto vargje:

*Sikur të ftohem prej tyre një ditë*

*Thoni për mua : Dritëroi ndjesë pastë!* (Agolli,1998: 37)

Për poetin gruaja është burimi i jetës, si dhe njëra nga arsyet pse ai ndihet i gjallë. Ai në poezitë e tij paraqet një dashuri të pastër ndaj saj, një dashuri të vërtetë e të ndjerë realisht për gruan.

Kjo dashuri në poezitë e këtij vëllimi herë na paraqitet me gëzim (kur gruaja ia kthen dashurinë) herë me trishtim (kur vjen ndarja mes dy të dashurve).

Dritëro Agolli shquhet, sidomos për guximin që tregon në hartimin e vjershave me karakter erotik. Poezitë e tij nuk flasin për një dashuri platonike, të imagjinuar, por një ndjenjë të vërtetë, tokësore dhe mjaft të fuqishme për gruan. *E tillë, plot ndjenjë, plot natyrshmëri, harmoni, muzikalitet dhe kuptim, poezia e dashurisë e Agollit përvetëson në brendësinë e saj të gjitha format dhe nuancat gjuhësore me të cilat dashuria funksionon gjuhësisht në mendjen e njeriut.* (Osdautaj, 2011: 60). Në këto vjersha e këngë dominojnë probleme morale dhe sociale që lidhen me dashurinë, por ka edhe të atilla, ku bukuria bëhet përmbajtje kryesore e frymëzimeve poetike. Motivi i dashurisë në këto vjersha dhe këngë përzihet shpesh me motive të tjera, si me atë patriotik, shoqëror etj. Kjo vjen si pasojë e kushteve ekonomiko-shoqërore e politike që kanë mbretëruar në kohën e krijimit të tyre.

Motivi erotik në vëllimin “Pelegri i vonuar” zhvillohet në dy linja kryesore: linja e parë përfshin përshkrimin e bukurisë së femrës, ndërsa linja tjetër, atë të dashurisë ndaj femrës-grua bashkëshorte.

Poeti do të bëjë një lutje e cila do t’i drejtohet një femre të paignifikuar, portreti i së cilës i ngjall parafytyrimin e relievit të një plantacioni dhe të të mbjellave të begatshme të tij, të cilat i krahason me pjesë të ndryshme të trupit të femrës:

*Lermë të shoh plantacionet e trupit tënd*

*Të mbjellat aq të begata*

*Dy kodrat e gjoksit që të lënë pa mend*

*Luginën mahnitëse mes kofshëve të bardha* (Agolli,1998: 16)

Këto vargje të marra nga poezia “Dëshira” përveç ndjenjës së dashurisë, shprehin edhe tërheqjen fizike. Ndryshe nga poezitë e tjera ku i kushtohet më shumë rëndësi shpirtërore, në këtë poezi jepet një aspekt tjetër, i kushtohet më shumë rëndësi trupit të femrës me të gjitha bukuritë që ka. Autori me mjeshtërinë e tij përshkruan pjesët e trupit duke i krahasuar me pjesë

nga natyra. Pjesët e trupit i quan plantacione, buzët e saj i quan qershi, duke nënkuptuar kështu që janë të kuqe e të ëmbla si qershi, kodrat nënkuptojnë gjoksin e saj, pjesën e barkut e quan fushë, kurse kërthizën e quan si një gropkëzë të argjendtë.

Poezitë kushtuar femrës si bashkëshorte i hasim shpesh në krijimtarinë e Agollit. Ai e vlerëson shumë bashkëshorten e tij e cila ka qenë pranë tij në çdo moment, qoftë të mirë ose të keq, dhe jo më kot i kushton asaj shumë poezi. *Prania e saj në këtë poezi është shpërblim mirënjohjeje dhe respekti.* (Bexheti, 2014: 150) . Ndjenjës së dashurisë, por njëkohësisht mallit për gruan bashkëshorte, Dritëro Agolli do t'i këndojë në vjershën “Qetësia e bukur”. Kjo është një poezi ku flitet më shumë për anën shpirtërore, për dashurinë e sinqertë të autorit ndaj gruas së tij. Edhe pse kemi fillimisht përshkrimin e bukurisë së saj të jashtme, autori nuk përqendrohet te e jashtëmja, por te ndjenja e fortë e dashurisë që ia përcjell gruaja e tij. Duke përshkruar bukurinë e saj të jashtme ai do që të tregojë se ajo fytyrë e bukur ka edhe një shpirt të madh e zemër të pastër që e detyron poetin ta dashurojë edhe më shumë. Në dy strofat e para të kësaj vjershe do të portretizohet figura e gruas-dashnore, e kjo do të arrihet me përdorimin e figurës së krahasimit dhe anaforës. Duke soditur gruan që fle në jastëkun e bardhë, ajo i duket e bukur si perëndeshat e lashta greke, por në një çast e pushton një ndjenjë fajësie e malli njëkohësisht, prandaj ashtu siç ishte ndeshur me Lekë Dukagjinin, personifikimin e kanunit, në vjershën “Mundja e Lekë Dukagjinit”, tani do të ndeshet me veten e tij. Ai ndihet fajtor pasi kur është larguar i ka lënë si barrë të gjitha punët e shqetësimet e shtëpisë gruas së tij. Poezinë e përfundon me këto dy vargje :

*“Të kam lënë mbi shpatulla gjithë shtëpinë*

*Fli e vuajtura ime!”* (Agolli,1998: 96)

Kjo poezi është në një farë mënyre falënderim dhe mirënjohje për gruan e cila edhe pse e vetme ka arritur të mbajë të gjithë barrën e shtëpisë dhe familjes, kur poeti nuk ka qenë i pranishëm.

*Personazhi i gruas që në vargjet e burrit poet paraqitet me tërë tiparet e një bashkëshorteje punëtore e fisnike, gjithmonë është e gatshme të sakrifikojë për të dhe poezitë e tij.* (Bexheti,

2012: 194). “Gruaja e poetit” është një poemth tjetër ku na paraqitet figura e gruas si bashkëshorte. E shoqja, mbështetja dhe forca më e madhe e poetit, jo vetëm që i jep mbështetje morale por edhe kujdeset që ai të mund të krijojë i qetë, duke u përpjekur të përfundojë të gjitha punët për shtëpinë e për familjen.

*“Mes rradhës hesht e mendt i venë*

*Te burri i vuajtur në shtëpi*

*U lodh me letër dhe me penë*

*U dogj mbi varg e poezi” (Agolli,1998: 144)*

Nëpërmjet këtyre vargjeve kuptojmë zemërgjerësinë e gruas, si dhe dashurinë e pastër që ajo ka për burrin e saj. Ajo nuk është aspak egoiste, mund të qëndrojë me orë të tëra në radhë për të bërë pazarin, por aspak nuk e mendon lodhjen e saj, përkundrazi shqetësohet për të shoqin poet që qëndron në shtëpi për të krijuar vargje. Paragjykimet e njerëzve nuk mungojnë aspak.

*Po pëshpëritje ndien në rrugë*

*Me gjemba fjalësh nëpër helm*

*“mëkon të shoqin kjo me lugë,*

*I shoqi vërr-vërr me kalem!...” (Agolli,1998: 144)*

Në këto vargje autori flet për mentalitetin shqiptar që paragjykon njerëzit pa marrë parasysh si është gjendja në të vërtetë. Ata e gjykojnë autorin i cili lë gruan të përfundojë të gjitha detyrimet, kurse ai bën veç “vërr-vërr me kalem” në fletore, duke nënvlerësuar kështu punën e tij. Gjithsesi gruaja ka përsëri besim te i shoqi i saj, dhe e di se puna e tij do të shpërblehet dhe të gjithë njerëzit që flasin për të do ta vlerësojnë punën e tij. Atë nuk e shqetësojnë këto gjëra, për të është e rëndësishme vetëm që burri i saj poet të krijojë poezi.

Autori është shumë i vetëdijshëm dhe falënderues për dashurinë dhe mbështetjen që i fal gruaja e tij, ndaj e krahason të shoqen me statujat e perëndeshave që gjenden në Butrint :

*Për një statujkë llërëzbehtë*

*Një perëndeshëz në mermer*

*Kurse statuja e vërtetë*

*Në radhë djathi jep e merr!... (Agolli,1998: 145)*

Nga këto vargje nënkuptojmë se ai e lartëson figurën e gruas më shumë se të perëndeshave në Butrint, pasi është gruaja e tij e cila sakrifikon dhe lodhet çdo ditë për të përmbushur detyrimet në jetën e tyre.

Në poezinë “Pasuria” përveç se autori shprehet falënderues për gjërat e pakta që ka në jetë, është më se i lumtur që ka pranë tij një grua besnike. Duke qenë se është poet, njerëzit rreth tij mendojnë se ai ka shumë të mira materiale. Autori e mohon këtë gjë me vargjet e strofës së dytë të kësaj poezie :

*“Dërrasa me libra dhe katër karrike*

*Një sobë e një raft të vjetër,*

*Një lakër për drekë e një grua besnike*

*Dhe s’kam asgjë tjetër” (Agolli,1998: 131)*

Pra të gjithë pasurinë e tij e ai e tregon në këto katër vargje, ku thekson gjërat më të rëndësishme për të, të cilat ishin libri, soba për tu ngrohur, ushqimi dhe mbi të gjitha gruaja besnike, e cila i gjendet pranë në të mirë e në të keq. Për poetin nuk kanë rëndësi “garderobat e fryra” por bashkëshortja e tij që i qëndron afron dhe është pasuria më e madhe e poetit.

Një poezi mjaft tërheqëse me personazh gruan si bashkëshorte, është poezia e shkurtër “Rubai”. Këto janë vargjet e kësaj poezie:

*Sa më e mirë të jetë gruaja,*

*Aq më shumë grindet me burrin,*



*Këto mendime ju duken të huaja?*

*Pyetni të mënçmen e grave tuaja! (Agolli,1998: 113)*

Kjo është një poezi e shkurtër vetëm katër vargëshe, me rimë A-B-A-B, në vete mbart një mendim mjaft interesant. Në thelb të saj është gruaja në rolin e bashkëshortes, e cila sa më shumë grindet me burrin aq më e mirë e më e zonja është. *Sipas studiuesit Osdautaj, ai (Agolli) është kundërshtar i gruas në aspektin që ajo e kundërshton burrin në çdo ndërmarrje të tij, gjë që asaj nuk i shkon për shtati.* (Osdautaj, 2011: 93). Nga këto vargje ne kuptojmë se autori e quan një grua të mirë nëse ajo di të kundërshtojë bashkëshortin e saj kur është gabim, dhe pikërisht kjo kundërvënie çon deri te grindjet e shpeshta.

Në poezinë “Do më kujtosh” përveç motivit erotik paraqitet si motiv i dytë vdekja. Edhe pse nuk e përmend në vargjet e tij autori e nënkupton atë gjë kur i thotë gruas së tij që ta kujtojë. Kuptohet që ai i lutet asaj ta kujtojë kur ai të mos jetë më me të në këtë botë. Për të qenë gjithmonë pranë saj autori do të shkruajë një libër me vjersha :

*Unë do të shkruaj një libër me vjersha*

*Dhe ti do ta lexosh si relikë*

*Dhe duke qëruar patate të ardhura nga vjeshta*

*Gishtin do të presësh me thikë (Agolli,1998: 20)*

Agolli e vendos gruan në një ambient fare të thjeshtë, pa zmadhime, pa ekzagjerime, duke nxjerrë kështu në pah edhe një cilësi të saj, pra sa amvise e mirë është ajo e sa kujdeset për familjen. Ai do të jetë pjesë e saj edhe pas vdekjes, për këtë arsye ka shkruar këto vargje në formë testamenti që gruaja e tij t’i lexojë “si relikë”. Për rikujtimin e tij pas vdekjes, kemi edhe poezi të tjera të autorit, që përmenden më poshtë në kapitullin mbi temën e vdekjes në këtë vepër, por edhe në poezi të përmbledhjeve të tjera poetike të botuara nga Agolli. Vlen të përmendim në këtë rast njërin nga poezitë më të njohura të tij “Kur të jesh mërztur shumë” ku autori porosit gruan e tij që nëse do të ndjejë mungesën e tij mund ta gjejë nëpër libra për tu çmallur me të. Dëshira e autorit për të qenë pranë gruas së tij, si dhe në kujtesën e zemrën e saj

edhe pas vdekjes është e madhe, gjë që kuptohet nga fakti se e përmend shpesh këtë gjë në poezitë e tij.

“Trëndafilat e turkeshës” është njëra nga poemat më të mira të kësaj përmbledhjeje me poezi. Më lartë e kemi analizuar këtë poemë nga aspekti atdhetar, por në fakt në këtë poezi nuk mungon as motivi erotik. Në vargjet e poemës vërehet qartë simpatia e heroit lirik për turkeshën e bukur. Përshkrimi i bukurisë së saj bëhet me anë të krahasimeve të ndryshme, prej të cilëve do të përmendim disa, nëpërmjet vargjeve :

*“Ah turkeshja uli **syçkat si dy gurë xhevahiri***

*Vinte Zylyftari i Podës hypur kalit bojëhiri” (Agolli,1998: 171)*

*“Po turkeshja hapi **buzkat si dy sure në Kuran***

*-Mos ma prish dëshirën mua, komunist e mysliman!” (Agolli,1998: 171)*

Edhe pse nuk tregohet një ndjenjë e fortë dashurie mes dy personazheve, është e kuptueshme që autori vendos një lidhje mes heroit lirik dhe turkeshës, që pavarësisht diskutimit për Shqipërinë e Turqinë, përsëri pëlqejnë të kalojnë kohën së bashku.

Edhe pse dashuria është një ndjenjë e fortë dhe e bukur nuk do të thotë që ajo nuk përcillet nga gjëra të trishtueshme, siç mund të jetë ndarja, te e cila mund të vihet për arsye të ndryshme. Një poezi ku autori nuk flet më për dashurinë si një ndjenjë e bukur, e lumtur është “Pas ndarjes” ku flitet për ndarjen nga e dashura e zemrës dhe njëkohësisht flet për dhimbjen që ndjen. Që në vargun e parë poeti thekson se ndarja ka ndodhur natën, për ta bërë këtë më të dhimbshme. Nata është e errët, na përkujton vuajtjen, vetminë, nuk ka gjallëri, pikërisht për këtë arsye poeti përcakton natën si kohën e ndarjes, për ta lidhur njëkohësisht edhe me gjendjen shpirtërore që përcjell ndarjen.

*“Ajo më la përngaherë atë natë*

*Dhe unë i munduar si një kalorës*

*Me plagë kthehesha rrugës së gjatë*

*Kur shkrinte fundi i dëborës” (Agolli,1998: 82)*

Dashuria me atë vajzë ka qenë një sfidë në vete, dhe ka qenë një rrugë e gjatë e mbushur jo vetëm me gjëra të bukura, por edhe momente të trishta, të lodhshme, për këtë arsye poeti ndihet si një kalorës i lodhur i rikthyer nga beteja e luftës, në fakt i dërmuar shpirtërisht. Gjithsesi ndjenjat kanë qenë të forta prandaj në fund të këtij rrugëtimi ai është i mbushur me plagë të cilat ia ka shkaktuar vajza që ka dashuruar. Plagët janë fjalët e thëna e kujtimet e përjetuara nga të dy gjatë kohës që kanë qenë bashkë. Karakteristikë e Agollit është të përfshijë edhe objektet rrethore në poezitë e tij për të shprehur kështu më mirë ndjenjat e tij, për të shpalosur gjendjen e tij shpirtërore. Në këtë poezi, këtë fenomen e vërejmë në dy strofat e fundit. Le të përmendim disa prej vargjeve:

*“Oxhaku i shtëpisë villte shkëndija”*

*“Në kthina kërcisnin nallane dhe enë”*

*“Në ahur çukisnin brirët e qeve”*

*“Në qiellin e turbullt lecat e reve*

*E lidhnin hënën si plagë...” (Agolli,1998: 82)*

Te të gjitha këto vargje që janë marrë nga poezia “Pas ndarjes” japin një ambient të qetë por melankolik që lidhet njëkohësisht me gjendjen shpirtërore të poetit. *Nuk janë imazhet e objekteve ato që arrijnë ta rrumbullakojnë ndjenjën e heroit lirik, por formësimi i ndjenjës së heroit lirik bëhet përmes asaj se si truri i tij, në momentin e cekur, e sheh funksionimin e gjërave.* (Osdautaj, 2011: 71)

Poezia të tjera me elemente erotike, që i kushtohen një femre, bukurisë së saj ose thjeshtë ndjenjës ndaj saj, e këto janë : “Dikur në rini” (fq. 140), “Loja” (134), “Perdja” (fq.121).

## Tema e pleqërisë dhe e vdekjes

Agolli ishte një poet që e donte jetën dhe shkruante për të gjitha fazat e saj, për të filluar me fëmijërinë, por duke arritur deri tek fazat jo aq të dëshirueshme nga njeriu siç janë pleqëria dhe vdekja. Pleqërinë e gjejmë shpesh si motiv në poezitë e Agollit, diku ku ai shprehet si plak, e diku përshkruan pleq të tjerë. Kur njeriu vjen në moshën e pleqërisë, çdo gjë që përmend dhe mendon është e kaluara e tij, rinia me një fjalë. Këtë gjë poeti e përshkruan në poezinë “U rrahën pleqtë” ku në mënyrë simbolike tregon se si pleqtë debatojnë vetëm për të shkuarën, dhe të pakta mund të jenë diskutimet për kohën e tashme. Këtë e shpreh me anë të vargjeve :

*“Pleqtë rrihen veç për të moçmen*

*Dhe ndofta çirren dhe pak për të soçmen” (Agolli,1998: 42)*

Kujtimet e pleqve për të kaluarën i tregon edhe në poezinë “Nostalgjia e plakës” në të cilën ballafaqon të rejën dhe të vjetrën, përplasjen mes brezave që nuk kuptohen me njëri-tjetrin. Plaka jeton me kujtimet se së shkuarës, shikon gjërat që i kanë mbetur nga rinia e saj dhe përkujton të shoqin që nuk e ka më pranë. Por të rinjtë, nusja e djalit në këtë rast, nuk e kupton mallin dhe nostalgjinë e saj :

*“Dhe nusja e djalit e sheh dhe prish cepin e buzës*

*Me kokën e bukur mënjanë:*

*Vështrimin plaka e ndjen me duart kryq sipër bluzës*

*Dhe thotë me vete: “Po ç’kanë me mua, ç’kanë?” (Agolli,1998: 50)*

Procesin e plakjes, si në aspektin fizik si në aspektin mendor e shpirtëror e përshkruan në disa poezi, edhe atë “Të kërrusur në rrugë”, “E shoh se po plakem”, “Fytyra”, “Zgjimi nga gjumi”

Te poezia “Të kërrusur në rrugë” autori me anë të krahasimit përshkruan pamjen fizike të një plaku duke e lidhur edhe me anën shpirtërore. Kërrusjen e shpatullave e justifikon me mbajtën

e maleve në shpinë. Kuptohet që kjo është një shprehje simbolike, pasi ajo që do të thotë autori është se gjatë gjithë jetës njeriu ka bartur mbi shpinë probleme, vështirësi, barra të rënda, prandaj në pleqëri nuk është më i drejtë dhe i qëndrueshëm si në rini, por kërruset nga pesha e rëndë që i ka vënë jeta. Rrudhat në fytyrën e plakut ai i krahason me rrudhat e shkëmbinjve ku kanë kaluar përrenj. Njeriun, pra, e quan shkëmb që ka përjetuar dhe u ka bërë ballë aq vështirësive në jetë, pa u dorëzuar, duke qenë i fortë si shkëmbi, por të gjitha dhimbjet e problemet kanë lënë shenjë tek ai. Pra të gjitha rrudhat në fytyrën e pleqve pasqyrojnë atë që ata kanë përjetuar në jetë.

Në poezinë “E shoh se po plakem” autori tregon se ka filluar të ndjejë shenjat e pleqërisë edhe te vetja e tij. Dridhja e dorës nënkupton lodhjen fizike që vjen bashkë me pleqërinë. Atij nuk po i lodhet më vetëm trupi, por po i humbin edhe vargjet, nuk mundet më të shkruajë si më parë, gjë që e përshkruan në këto vargje :

*“E shoh se po plakem*

*Dora në tryezë më dridhet mbi letër*

*Dhe vargjet po vaken*

*Si uji në tenxheren e vjetër” (Agolli,1998: 55)*

Ai habitet me gjendjen e tij, duke qenë se i ri ka qenë aq energjik, aq i aftë për të shkruar, kurse tani është vërtet një plak që i dridhet dora.

Ndryshimin e pamjes së jashtme Agolli e përshkruan në poezinë “Fytyra”. Tani që është plakur fytyra e tij i duket e shëmtuar. Kjo gjë nuk e shqetëson poetin, i cili do ta përdorë pamjen e tij për të trembur njerëzit, e me këtë ai do të kënaqet.

*Dua t’i tremb ata që më shohin*

*Dhe shpejt t’i rrënoqeth*

*Të futen në vrima dhe portës t’i vënë llozin*

*Dhe unë të qesh* (Agolli,1998: 58)

Ai ndjen mall për fëmijërinë e tij, përpiket që të rikthehet në atë kohë. Në strofën e parë të poezisë “Zgjimi nga gjumi” autorit i shfaqet si vegim fëmijëria, por shpejt kjo gjendje do të përfundojë, ai do të kuptojë se realiteti është krejt ndryshe, tashmë ai ishte një plak:

*Pastaj në pasqyrën-kristal një fytyrë*

*E vyshkur me rrudha shumë*

*Dy lotë prej plaku me flokë me lyrë*

*Dhe ky isha unë...* (Agolli, 1998: 204)

Megjithatë Dritëro Agolli do përsëri rininë t’i kthehet. Për ta rikthyer këtë ka gjetur një mënyrë interesante: të fusë gjysmat e viteve në torbë. Këtë ide të perealizueshme ai e përshkruan në poezinë “Fantazi”. Duke qenë se gjysmat e viteve nuk do t’i ketë më, ai me energjinë dhe entuziazmin e një të riu do të niset në udhëtim, e kur njerëzit do ta pyesin se si arriti të kthejë rininë ai do të përgjigjet :

*“Vërtet jam i ri pa rrudha e thinjë*

*E lashë gjysmën e viteve në torbë”* (Agolli,1998: 62)

Vdekja është një motiv që përmendet shpesh në krijimtarinë letrare të Dritëro Agollit. Arsye mund të kenë qenë të ndryshme. Çdo njeri do të vdesë një ditë, do ta përjetojë atë gjë, pikërisht për këtë autori mund të ketë menduar shumë për vdekjen, mund të jetë trembur prej saj por edhe mund të ketë qenë edhe kurioz për atë ndjesi. Gjithsesi në poezitë e Agollit vërejmë se ai vdekjen nuk e sheh si një largim absolut nga kjo botë, ai mendon se nëse trupi i njeriut tretet në varr, vepra dhe kujtimi i tij mund të jetojnë shumë gjatë. Në shumë prej poezive të tij ai shprehet se e pret vdekjen, se sado e vështirë të jetë ajo, ai do të mësohet edhe të vdesë :

*Tani më duhet të mësoj edhe shkopin mirë*

*Për tu mbështetur kur të dal në mëngjes,*

*Pastaj më pret një mësim pak më i vështirë:*

*Të mësoj dhe të vdes* (Agolli,1998: 64)

Siç e shohim nga këto vargje, autori e pret vdekjen dhe do të përgatitet për ardhjen e saj. Vdekja është padyshim një dukuri jo e dëshirueshme nga njeriu, sidomos nga Agolli që e donte aq shumë jetën, tokën dhe natyrën. Këtë ndjenjë frike poeti e paraqet në poezinë “Frika e vdekjes” në të cilën ai shpreh dëshirën që të ketë një vdekje të qetë, pa lënguar ndonjë sëmundje e tmerrshme. Dritëroi gjithashtu shprehet mirënjohës që nga gjendja shëndetësore është mirë dhe këtë gjendje ai e “fakton” me faktin që *“për mua s’është vështirë në vargje të njoh symbyllur sinorët e pragjet”*.

Në poezinë “Dita e nesërme” motivi i vdekjes është pak i paqartë. Autori është në pritje të ditës së nesërme, por ajo mund të vijë ose jo. Në fakt dita e nesërme do të vijë, por a do të jetë autori aty për ta pritur. Gjatë dy strofave të para autori e vë në dyshim lexuesin, por në strofën e tretë përcaktohet motivi i kësaj poezie.

*“Vjen a s’vjen unë e pres si shtërg në rërë*

*Në u vonoftë, i lë takim në varre*

*Atje lart te guri i zi me vërë*

*Ku do të shkojmë një nga një të tërë...”* (Agolli,1998: 70)

Pra autori mund të mos jetë gjallë deri sa të lindë dielli përsëri. Gjithashtu autori cek që pas tij edhe njerëzit e tjerë nuk do të jenë aty për të pritur ditën tjetër, por do ta presin në varr.

Përveç vetes së tij, ai do të përgatisë edhe njerëzit e afërt për kohën kur ai të mos jetë më. Në disa prej poezive ai lë në një farë mënyre amanetet e tij, duke u shprehur se si dëshiron të jenë gjërat pas vdekjes së tij. Poezi të tilla kemi : “Sot pasdite” (Agolli,1998: 57), “Testamenti” (Agolli,1998: 185) dhe “Epigrafi “ (Agolli,1998: 150).

“Testamenti” është një poezi ku autori lë amanetet e tij të fundit para vdekjes. Në këtë poezi ai nuk iu drejtohet njerëzve të afërt, por tokës, të cilën e donte aq shumë, të cilës i thuri këngë gjatë gjithë jetës së tij. Ai kërkon prej tokës ti sigurojë një varr të mirë. Dimë se autori ka qenë shumë i lidhur me natyrën, me tokën prandaj edhe do të prehet qoftë në një arë ku mbillet fara ose pranë një përroi. Duke qenë se do të prehet në një vend të tillë, ai nuk do ti humbë lidhjet me botën, gjë që e shpreh në këto vargje:

*“Mbi mua të tundë bishtin e saj një laraskë*

*Duke më sjellë lajme nga bota” (Agolli,1998: 185)*

Në poezinë “Epigrafi”, një poezi kjo me 5 strofë, në 3 strofat e para autori përshkruan vazhdimin e jetës, se si do të shkojë çdo gjë normalisht ashtu siç ka ecur gjithmonë. Por në strofën e katërt flet për veten, tregon se si ai nuk do të mund të shikojë ecurinë e vendit të tij, e gjithçkaje tjetër që e ka rrethuar, pasi do të gjendet në varr. Ai është i vetëdijshëm se edhe pa të do të ketë ditë dhe natë, do të ketë të rinj dhe pleq, si dhe :

*Do të ketë parti dhe shoqata*

*Patjetër dhe një president (Agolli,1998: 150)*

Në strofën e katërt të poezisë shpreh bindjet e tij, ku duke dashur të tregojë mbishkrimin mbi gurin e varrit të tij shprehet se ka qenë komunist kur ka qenë i gjallë. Kulmin e saj kjo poezi e arrin në strofën e fundit, e cila thotë :

*Ndonjë poetuc do të thotë:*

*“nuk qënka çrrënjosur ky qen?”*

*Një zë do të përgjigjet nën tokë:*

*“Jam hiri, të zotin në libra e gjen”!... (Agolli,1998: 150)*

Në këtë strofë gjejmë termin “poetuc”, por çdo të thotë autori me këtë fjalë? Me këtë term ai emërton të gjithë ata poetë të cilët shkruajnë, por në fakt nuk kanë talent dhe nuk botojnë



ndonjë vepër cilësore. Këtë si duket Agolli e përdor edhe në “konfrontimin” me kundërshtarët e artit të tij, të cilët vetë ai do t’i paraqesë të tillë që e kundërshtojnë artin e tij vetëm pse ka qenë komunist. Ky konfrontim i tij është i ashpër, aq sa i quan poetuc. Pikërisht ndonjëri prej këtyre poetëve do të kritikojë Agollin. Edhe pse në varreza dhe i vdekur fizikisht, poeti mendon se ai vetëm hirin e ka në varr, kurse shpirti i tij gjendet në libra, në krijimet e tij letrare, të cilat do t’i mbijetojnë kohës dhe do të jetojnë shumë më shumë se poeti. Pra vdekja e një poeti të mirë është vetëm fizike, varroset vetëm trupi i tij, sepse vepra e tij është e përjetshme. Revoltën ndaj “poetucëve” si i quan ai dhe kundërshtarëve të tjerë ai e shpreh edhe në poezinë “Profeti i nëmur”. Shumë prej kundërshtarëve e nënçmojnë veprën e tij, por ai është i sigurt dhe krenar për krijimtarinë e tij prandaj shprehet kështu:

*Qëlloni me fjalë e goditni me hekur,*

*Unë jam i pavdekshëm përgjersa s’kam vdekur... (Agolli,1998: 143)*

Në poezinë “Sot pasdite” që në vargjet e para nënkuptohet që autori tashmë ka ndërruar jetë. Gjithsesi ai jep porositë e tij se si do që t’ia përgatisin kufomën. Strofa e dytë përmban një porosi më të rëndësishme. Autori nuk do që të lartësohet pas vdekjes nga njerëz që në fakt nuk ia kanë dashur të mirën :

*Mos ngjitni në mure shkresa me vija të zeza*

*Dhe mos ftoni farefisnin dhe miqtë,*

*Askush mos mbajë fjalim në varreza*

*Mos qajnë e mos lavdërojnë të ligjtë (Agolli,1998: 57)*

Agolli nuk e do shtirjen, nuk i do fjalët e mira e dashurinë e njerëzve kur ai të ketë vdekur. Pikërisht për këtë arsye në ditën e vdekjes së tij nuk do që të jetë aty askush tjetër përveç familjarëve më të afërt, të cilët janë të vetmit që e duan sinqerisht atë. Ai është kundër fjalimeve prekëse të pandjera realisht dhe lotëve të shtirur të këtyre njerëzve që nuk e respektuan dhe se deshën me të vërtetë sa ishte gjallë.

Poezia "Lisat" flet po ashtu për vdekjen e vet autorit. Në strofën e parë autori përshkruan lisat e lartë e krenarë, të patrembur prej vdekjes, të cilën e presin në këmbë. Në strofën e dytë autori shpreh dëshirën që edhe ai të presë vdekjen në këmbë si lisat, duke shfaqur kështu trimërinë e tij dhe forcën për tu përballur me të :

*Ju më njihni, vdekjen ngaherë e kam sharë*

*Dhe kurrë s'jam fshehur prej saj nëpër drizat;*

*Në qoftë se vjen, dëshiroj të më marrë*

*Në këmbë si lisat (Agolli,1998: 179)*

Për sa i përket pranisë së njerëzve pas vdekjes së një njeriu, autori flet edhe në poezinë "Vdiq një njeri i vetmuar" (Agolli,1998: 53), ku autori përshkruan vdekjen e një njeriu i cili gjithmonë ka jetuar vetëm, pa pasur asnjë njeri pranë, e tani që është i vdekur në dhomën e tij qëndrojnë njerëz të tjerë. Në këtë poezi pasqyrohet filozofia e tij jetësore. Ai e di se jo të gjithë njerëzit e jetojnë jetën me privilegje, se ka të tillë që kanë jetuar të varfër dhe varfëria e tyre nuk lidhet vetëm me gjendjen sociale, por edhe me faktin që nuk lënë pas asgjë nga shpirtërorja. Duke qëndruar pranë trupi tashmë pa jetë të tij, njerëzit janë të turpëruar që nuk e kanë vizituar më shumë kur ishte gjallë, pasi tani ai kishte mbyllur sytë dhe nuk mund t'i shikonte më, s'fliste dot më me ta, pra nuk kishte nevojë më për ta.

*Heshtim dhe ne para shtratit të tij në dhomë*

*Dhe zemrat nga turpi i mbajmë në dorë:*

*S'i shkuam kur ishte gjallë, tani është vonë,*

*Qëndrojmë në këmbë në dhomën e ftohtë dëborë... (Agolli,1998: 53)*

Edhe në strofën e lartpërmendur, por edhe në dy strofat tjera të poezisë, autori përmend shpesh heshtjen e cila asocion shumë në vdekjen. Kur një njeri vdes, hesht ai përgjithmonë, heshtin njerëzit që e rrethojnë, heshtin edhe gjërat rreth e rrotull duke e ndjerë edhe ata në një farë mënyre humbjen e të zotit, pasi mbesin të braktisura. Veç heshtjes, në vdekjen na kujton

edhe i ftohti, dëbora. Në vargun e fundit të poezisë (që e lexojmë më sipër), poeti përmend të ftohtin e dëborën, gjë që nuk nënkupton se në çfarë stine ka vdekur ky njeri, por në atë mënyrë do të tregojë ndjesinë e ftohtë që përcjell vdekja. Një atmosferë pak a shumë e njëjtë jepet edhe te poezia “I vdekuri”. Edhe në këtë poezi flitet për heshtjen para trupit të të ndjerit. Autori shpreh një dëshirë që zhurma ta ngrinte të vdekurin, por është diçka e pamundur. Për këtë arsye dhomën e kaplon heshtja dhe askush nuk guxon të flasë :

*Përcjell te ne i vdekuri heshtjen,*

*Me heshtjen na bën të mendojmë për vdekjen. (Agolli,1998: 135)*

Vdekja e njeriut nuk është e vetmja që paraqitet në poezitë e Agollit. Në njërën nga poezitë me titull “Rekuiem”, autori flet për vdekjen e fjalës. Fjala vdes atëherë kur nuk ka vlerë më, edhe pse thuhet, kur ajo e humb ndikimin dhe peshën e mëparshme. Autori do të tregojë se në kohët e mëparshme njerëzit kanë qenë fjalëpakë e punëshumë, por në ditët kur ka jetuar ai ka dëgjuar më shumë fjalë boshë se sa vepra. Zhgënjimin e poetit e shton më shumë fakti që fjalët përdorshin më publikisht nga njerëz “të mëdhenj” të cilët ndonjëherë fjalën nuk e përdornin për qëllime të mira por për të sharë e për të ofenduar, për t’ia humbur kështu vlerën edhe asaj.

Vdekjen e fjalës ai e krahason me vdekjen e një njeriu, duke i quajtur të ngjashme si nga rëndësia që kanë, ashtu edhe nga jetëgjatësia, gjë që e tregon në vargjet në vazhdim:

*Ah, Fjala, njeriut të shkretë i shëmbëllen:*

*Lind, plaket e vdes siç shkruhet nga fati (Agolli,1998: 129)*

Pra duke vajtuar edhe vdekjen e fjalës edhe të njeriut, nënkuptojmë që autori i sheh ata të lidhura ngushtë me njëri-tjetrin, i quan një. Rrjedhimisht rëndësia e fjalës varet nga njeriu, sepse është ai që e flet dhe ai që e përcakton peshën e saj. Për rëndësinë e fjalës kanë folur shumë figura të njohura, filozofë, gjuhëtarë, poetë të tjerë. Duke lënë anash të huajt, mund të përmendim autorin shqiptar Martin Camaj i cili ka një poezi kushtuar fjalës, ku flet për rëndësinë e saj, e quan “strajcë në të cilën ne bartim të gjitha stinët” si dhe thotë se edhe buzëqeshja nuk do të kishte kuptim pa fjalën.

Në shumë nga poezitë e këtij motivi gjejmë lidhjen mes jetës dhe vdekjes, duke i konsideruar që të dyja të pandara. Këtë lidhje e vërejmë te poezia “Trokitja” ku autori përshkruan periudhën pas vdekjes së nënës së tij. Këtu vjen në shprehje lidhja mes botës së përtejme dhe botës së të gjallëve. Plaka që vjen troket çdo ditë në derë, autorit i duket sikur i sjell frymën e nënës së tij të vdekur pak kohë më parë. Mos vallë është shpirti i nënës së tij, apo është thjesht një plakë që vërtet ka nevojë, prandaj troket në atë derë? Pikërisht këto pyetje e mundojnë vetë poetin dhe i shkaktojnë dhimbje atij :

*Me krye në duar qëndroja i heshtur:*

*Pak kohë më parë nëna ime kish vdekur.*

*Nga ç’vende vinte, nga ç’rrugë e sokakë*

*Me frymën e nënës sime kjo plakë? (Agolli,1998: 130)*

Kjo lidhje midis dy botëve që përzihen njëra me tjetrën vihet re edhe në poezinë “Ëndërr e llahtarshme”, ku të vdekurit kërkojnë shtëpinë nga të gjallët. Kjo ngjarje edhe pse i shfaqet në ëndërr autorit, ngjall te ai ndjesinë e frikës dhe drithërima, duke përcjellë edhe te lexuesi ndjesinë e ftohtë që krijon vdekja te të gjallët.

Poezi të tjera ku përmendet vdekja në përmbledhjen poetike “Pelegri i vonuar” janë “Mos vdis”(fq.97), “Me ndershmëri” (fq.100), “Qentë”(fq.116), “Mbrojtja e ëndrrave” (fq.120), “Gërmadhat e mullirit”(fq.184), “Takimi” (fq.189), “Të qarat” (fq.211) etj.

Përveç vdekjes, në shumë poezi të tij përmenden edhe varrezat që janë të lidhura ngushtë me atë. Poezitë në të cilat përmenden varri ose varrezat në përgjithësi janë: “Pritja” (fq.12), “Sot pasdite” (fq.57), “Ëndërr e llahtarshme” (fq.108), “Fluturat e varrezave” (fq.118), “Mbrojtja e ëndrrave” (fq.120), “Rekuem” (fq.129), “Epigrafi”(150), “Gërmadha e mullirit” (fq.184), “Takimi” (fq.189), “Era e natës së dimrit” (fq.187) etj.

## Tema e përmbysjeve politike dhe thyerjeve shpirtërore

Fati historik i popullit frymëzon poetët dhe në të shumtën e rasteve përcakton ngjyrën e disponimit të tyre poetik. Përmbysjet e mëdha politike që ndodhën në shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore, e veçanërisht në Shqipëri përcaktuan ngjyrën e disponimit poetik të Dritër Agollit. Periudha e tranzicionit që një periudhë e tronditjeve të mëdha shpirtërore, ajo u përcoll me drama të dhimbshme dhe shqetësuese, të cilat lanë gjurmë të thella në kujtesën e popullit.

Zhvillimi dramatik i ngjarjeve dhe ndryshimet e paimagjinueshme politike u bënë objekt frymëzimi dhe lëndë me të cilat poeti Dritëro Agolli brumosi poezitë e librit “Pelegri i vonuar.

Pesëdhjetë vitet e sistemit totalitar, Shqipërinë e katandisën në një krizë të thellë ekonomike, morale e të besimit. Dritëro Agolli dhe poetët e brezit të tij kishin besim në ndërtimin e një shoqërie ku njerëzit jetonin në liri dhe në barazi, ku të mos kishte padrejtësi dhe gjyftime të ndërgjegjes; ata kishin besim në një shoqëri të individit të lirë, ku çdokush ishte i lirë të mendonte siç donte, ata prisnin që të vinte kjo ditë, duke i falur shtrembërimet dhe gjymtimet që i vërenin në të sotmen, pasi mendjen e kishin drejt të nesërme.

Për të pasqyruar më realisht dhe më me gjallëri krizën e thellë që kishte kapluar Shqipërinë, poeti në vjershën “Varfëria” vë përballë njëri-tjetrit labët dhe italianët të ndeshur mes tyre gjatë luftës Nacional-çlirimtare, në beteja të përgjakshme. Atëherë labët me një heroizëm të pashoq luftuan heroikisht me armikun, ndërsa sot sulen mbi ndihmat që sjellin italianët:

*“U hodhën me rrebesh përmbi kutitë*

*Dhe gunat mbi kutitë lanë*

*Ata që topin dje në Drashovicë*

*Nga gryka zinin me Selam Musanë” (Agolli, 1998: 10)*

Atmosferën e zymtë dhe të pashpresë që kishte kapluar Shqipërinë, poeti do të pasqyrojë në vjershën simbolike me titull “Gri”. Duke iu referuar fjalorit poetik, e sidomos duke lexuar me vëmendje disa vargje të kësaj vjershe si p.sh

*“Ikën lejlekët larg në arrati*

*Pikojnë strehët plot me melankoli*

*Postier përtaci vjen në shtëpi*

*Me pallto gri me letra gri*

*Gazeta hapej me tituj gri” (Agolli, 1998: 13)*

Vijmë në përfundimin se shkaktari kryesor i përhapjes së ngjyrës gri kudo është pikërisht kriza ekonomike, morale dhe politike, por mbi këto edhe eksodi masiv i të rinjve dhe të rejave shqiptare nga vendi i tyre. Eksodi paraqet një nga ngjarjet më të dhimbshme të historisë më të re shqiptare, që si e tillë ka lënë gjurmë të thella në jetën e njerëzve, poashtu në shpirtin e poetit. Grija është një ngjyrë që simbolizon vetminë, zymtësinë, duke na paraqitur kështu edhe gjendjen shpirtërore të poetit. Meqë kjo ngjyrë gjendet kudo, autori do të tregojë se në atë kohë, në vend nuk kanë ekzistuar ngjyrat, pra me një fjalë nuk ka pasur lumturi e gjallëri, por vendi është kapluar nga zymtësia për shkak të problemeve të kohës. Të njëjtin motiv e kemi edhe te poezia “Në gërmadhë” ku paraqitet gjendja e keqe që ka kapluar vendin.

*“Çdo gjë e rrënuar e çdo gjë gërmadhë,*

*Gërmadhë në rrugë e gërmadhë në shpirt*

*Vajton kukuvajka, vjen korbi vërdallë*

*Çdo gjë e rrënuar e çdo gjë gërmadhë” (Agolli, 1998: 14)*

Për ta përshkruar këtë atmosferë të zymtë, poeti nuk e përdor më ngjyrën gri, por përmendet gërmadhat dhe shtazët që paralajmërojnë zinë si kukuvajkën dhe korbin. Vaji i kukuvajkës dhe korbi që shkon rrotull gërmadhave simbolizojnë të keqen që ka kapluar vendin. Ai gjithashtu

përmend termin “gërmadhë” për të përshkruar gjendjen e mjerë të vendit, pra asgjë nuk ka mbetur, çdo gjë është shkatërruar dhe vendi është në mjerim të plotë. Gjithsesi edhe në këtë mjerim autori përpiket të gjejë shpresën :

*“Çudi! Në gërmadhë cicërin harabeli:*

*Miss Albania, Albania Miss!*

*Ndërsa veç një vrimëz e ndritur nga qielli*

*Çudi! Në gërmadhë cicërin harabeli!” (Agolli, 1998: 14)*

Nëse në strofën e parë poeti shpreh një pesimizëm të theksuar, që e përcjell edhe te lexuesi një ndjesi të ftohtë për rrënimin e vendit, në strofën e dytë të poezisë jep një rreze shprese. Këtë të fundit e përcjell te lexuesi me anë të paraqitjes së harabelit, cicërima e të cilit dëgjohet në gërmadhat e vendit. Në një vend të shkatërruar ku dëgjohet vetëm zëri i kukuvajkës dhe të korbit, përsëri mund të gjendet shpresa, cicërima e një harabeli të vogël jep sinjalin që aty ka përsëri jetë, që mund të lulëzojë e të ndërtohet jeta mbi ata gërmadha.

Në këtë vëllim ka edhe mjaft vjersha të lidhura drejtpërdrejt me ngjarjet e kohës si : “Mos ma kujto”, “Kishat e shembura” etj. Krahas krizës së thellë ekonomike Shqipërinë e kishte kapluar edhe një krizë e thellë morale dhe politike. Këtë krizë do të mundoheshin ta shfrytëzjnë njerëzit të cilët mendonin se janë duke bërë diçka për historinë e vendit. Por historinë nuk e bëjnë grykësit, batakçinjtë e pehlivanët që i kanë sytë e mendjen e thelat e duan të hanë në sofrën e shtruar të historisë. Atyre sipas poetit, historia u jep një kafe në këmbë dhe u thotë :

*Na falni se presim në sofër të vijnë*

*Ata që bëjnë vërtet historinë (Agolli, 1998: 26)*

Historinë e bëjnë heronjtë, por autori shprehet se në atë kohë nuk ka heronj, as ideal, por vetëm matrapazë.

*“Ç’digjeni nga malli për heronjtë?*

*Kushedi kur kthehen nga kjo anë!*

*Ç’i kërkoni? Pritja është e kotë*

*S’ka heronj, tani ka pehlivanë” (Agolli, 1998: 26)*

Në mesin e këtyre pehlivanëve ka edhe intelektualë snobë, që e mohojnë poezinë e krijuar në kohën e totalitarizmit duke kërkuar që të fillohet e gjitha nga e para. Dritëro Agolli nuk e mohon “atë të bukur dhe humane” që e kanë sjellur bashkë me poetët tjerë të brezit të tij. Ai para lexuesit me sinqeritet dhe dhembje zbulon dilemat dhe mëdyshjet e kohës, brerjet e ndërgjegjes dhe me vargjet e tij na e thotë të vërtetën, ndonëse të hidhur, por të ndershme:

*“E shkuara ka kohë dhe çaste të hidhura, mos ma kujto*

*Ka drojtje dhe heshtje, kur lipsen të thirrura*

*Mos ma kujto” (Agolli, 1998: 18)*

Disa vargje të Agollit na përkujtojnë edhe temat e trajtësuara nga poeti i mjerimit, Migjeni. Fati tragjik i njeriut të thjeshtë dhe të ndershëm në këtë kohë të pehlivanëve do ta brengosë thellë poetin, ashtu siç e kishte brengosur edhe Migjenin para më se një çerek shekulli. Pikërisht këtij fati do t’i këndojë në vjershën “Përrulja e madhe”:

*“S’gjen dhimbje më të madhe, në ke parë*

*Njerinë e ndershëm në mjerim e vaj*

*Tek lutet i përrulur e zemërvrarë*

*Dhe ndihmë e shpresë pret nga maskaraj” (Agolli, 1998: 88)*

Atmosfera që përshkon këto vargje flet mjaft për disponimin e ngrysur të poetit. Ne mund të kuptojmë mirë shpirtin e poetit nga fjalët që ai përsërit shpesh në poezitë e tij, si p.sh te Agolli vërejmë shpesh fjalët vetmi, trishtim, frikë, mërzi, dhimbje, pikëllim, gri, pelegrin, që hasen si



tituj të poezive. Këto fjalë shpalosin botën ideoemocionale të poetit dhe ngjyrosin emocionalisht ligjërimin e tij poetik. Gjendja e trazuar shpirtërore dhe disponimi i ngrysur i poetit janë pasojë e vetmisë, të cilën nuk mund ta durojë natyra e hapur e tij, ndërsa shkaqet e kësaj vetmie do të dëshmojnë më së miri me anë të këtyre vargjeve :

*“Po iki me trishtim i zhgënjyer nga miqtë*

*E mbylla dhe derën që rrinte hapur*

*Për lajkatarët, për rrenacakët e smirëzinjtë,*

*Që shtireshin ëngjëj të dashur” (Agolli, 1998: 8)*

Në këto vargje vërejmë zhgënjimin dhe pikëllimin e tij të thellë, të shkaktuar nga njerëzit rreth tij, të cilët ai i ka mbajtur pranë duke menduar se e mbështesin dhe janë të sinqertë kundrejt tij, por në fakt ka ndodhur e kundërta. Për këtë arsye Agolli në mënyrë simbolike shprehet se mbyll derën, pra nuk pranon askënd pranë tij nga frika se do ta zhgënjejnë përsëri.

Në këtë kohë të përmbysjeve politike dhe të plakjes fizike të poetit vërehet ndoshta një lëvizje sadopak e vogël e botëkuptimit të tij për poezinë, edhe pse nuk mund të bëhet fjalë për ndërrimin e pikëpamjeve themelore. Kjo mbase vërehet që në titujt e dy cikleve: Dhimbjet e karvanit dhe Psherëtimat e vjeshtës.

Tema e përmbysjeve politike, e thyerjeve shpirtërore, e shprehjes së dramave të kohës etj. paraqet fushën kryesore të interesimeve tematike të këtij vëllimi, por njëkohësisht edhe anën më të mprehtë dhe më të rëndësishme të tij.

## FIGURA E KALIT NË POEZITË E AGOLLIT

Dritëro Agolli njihet si një nga autorët që kanë dashur më së shumti natyrën, fshatin, kafshët. Në poezitë e tij gjejmë shpesh bujkun, tokën, si dhe kafshët në përgjithësi. Kafsha më e dashur dhe më e përmendur në poezitë e Agollit është kali.

Vështirë të gjendet tjetër poet shqiptar, si ai, qoftë i traditës qoftë bashkëkohor (ndoshta edhe i huaj), që të ketë treguar kaq shumë interes dhe të ketë shkruar kaq shumë vargje dhe prozë për kuajt, me kaq përkushtim, dashuri, altruizëm dhe humanizëm që zgjatet deri në zoomorfizëm. *Nuk ka përmbledhje poetike, roman, novelë apo qoftë edhe intervistë të D. Agollit që të mos ketë tituj, vargje, sentenca ose rreshta për kalin, pelën dhe mëzin.* (Zisi,2014: 19)

Në veprën “Antologji poetike për kuajt” nga autori Roland Zisi gjejmë 33 poezi dhe 2 proza poetike ku përmendet kali ose që i kushtohen tërësisht kësaj kafshe. Pra ky është numri i plotë që e gjejmë në të gjithë krijimtarinë letrare të Agollit. Për sa i përket veprës “Pelegri i vonuar” në të gjejmë 5 poezi në të cilat përmendet kali. Këto poezi janë : “Ikona” (fq.31), “Kali plak” (fq.9), “Një kalë i bardhë” (fq.19), “Kali” (fq.89), “Ëndërra e prerë”(fq.97), “Dy gurë të rënë nga mali” (fq.111)

Agolli e sheh kalin jo si një kafshë të thjeshtë por si një figurë shumë të rëndësishme në jetën e tij. Për Agollin kali ka shumë virtyte si besnikërinë, shpejtësinë, pastërtinë, elegancën, bukurinë etj. Të gjitha këto e bëjnë kalin një kafshë të veçantë.

Dritëroi që i vogël ka qenë i lidhur me kuajt, gjë që e përmend shpesh në kujtimet e tij për fëmijërinë. Shembull konkret e kemi poezinë “Kali plak”, ku ai tregon për kalin e tij, me të cilin ka kaluar shumë kohë kur ka qenë fëmijë :

*O kali im plak, o gërdalli im plak*

*Kapërcyem një prag, na shty edhe pak*

*Andej nga nxitojnë lejlekët në varg* (Agolli, 1998: 9)

Autori shprehet se do të vazhdojë akoma udhëtimin me kalin e tij, nuk do që ta humbë atë, pasi e konsideron si një qenie shumë të dashur për të, si një bashkudhëtar e si një mik të mirë, jo vetëm si një kafshë që shfrytëzohet për të udhëtuar ose për të kryer punë të tjera. Ai e ka shoqëruar atë edhe kur kanë goditur rrufetë, në rrugët me gropa, çdo agim e perëndim dielli. Poetin e tremb mungesa e kalit të tij, prandaj i lutet që të mos dorëzohet, gjë që e shohim në këto vargje:

*O kali im plak, me thundra me gjak*

*E di se do mekesh, po prit edhe pak,*

*Se fryma si jotja dhe mua m'u vak... (Agolli, 1998: 9)*

Gjithashtu poezi të tjera ku gjejmë vetëm disa vargje për kuajt janë “Ëndërr e prerë” dhe “Dy gurë të rënë nga mali”

*“Mos vdis, se kalit i ra në vrapim një potkua*

*Dhe nisi ta ngrerë nga dhëmbja këmbën e parë” (Agolli, 1998: 97)*

Ose

*Dy kuajt tanë mbi bar hapin sytë*

*Lëshuar nga kapistalli,*

*Ne shtrirë mbi shpinë shohim yjtë,*

*Jemi dy gurë të rënë nga mali (Agolli, 1998: 111)*

Në krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit gjejmë edhe baladat, të cilat mund të kenë motive të ndryshme. Në baladat e këtij autori zakonisht ka një ngjarje që zhvillohet si dhe personazhë të ndryshëm.

Një nga baladat më të mira, ku gjejmë kalin si figurë është poema “Kali” e cila është ndërtuar mbi bazën e një aventure kalorsiake të heroit të saj Limo Labinotit. *Atmosferën tipike mediterane të kësaj vjershe baladike, që ka në vete diçka lorkiane, e krijojnë :*

*mejhania, qemanie, pija (rakia), muzika, vallet, kali, mullari, hënga, çengia.* (Vinca, 2004: 151)  
Balada ndahet në tri pjesë. Në pjesën e parë Limoja, i cili kishte dalë në Pazar të blinte një qemane, duke u mburrur mes çingjive, thotë :

*“Kush e ka qemanen më të mirë,*

*Për qemanen unë i jap një kalë “ (Agolli, 1998: 89)*

Këtu fillon drama e tij e brendshme, sepse fjala e thënë nuk mund të tërhiqet, ndërsa kali ishte e vetmja pasuri që ai kishte në jetë, prandaj ai me dhimbje kujton humbjen e tij dhe dëshiron që :

*Harkun e qemanes ta bëj kalë*

*Dhe qemanen kodër mbi një fushë,*

*Të trokasin thundrat valë-valë*

*Kur ta vë nën sup, ta mbaj nën gushë (Agolli, 1998: 90)*

Në pjesën e dytë përshkallëzon konflikti: vjen momenti që Limoja vendos ta japë kalin e tij për qemanen, por në atë moment vendos që së bashku me qemanen të marrë edhe çingjinë që t'i tregojë asaj “si rri hëna mbi mal” si dhe “barkun e mullarit” që mund të bëhej një nga shtretërit më të lumtur.

Në pjesën e tretë të baladës vendoset një nga skenat më të lira, skena e aventurës erotike të Limo Labinotit me çingjinë, për të cilën e humb kalin. Kjo skenë është përshkruar me shumë sensualitet, gjë që e vendos këtë baladë në kulmet e poezisë erotike shqipe. Kur kthehet në fshatin e tij të gjithë e përqeshin dhe e quajnë “të marrë”, pasi lejoji të humbë një gjë aq të rëndësishme sa është kali, për një qemane e cila nuk do t'i hyjë në punë aq shumë.

## POEZI PËR POEZINË

Një nga dashuritë më të mëdha të Dritëro Agollit është letërsia, më konkretisht poezia. Për të të shkruarit nuk ishte thjesht një profesion, por ishte një pasion i madh të cilit ai ia kushtoi tërë jetën. Për poezinë ai la pas shumë gjëra siç e tregon edhe te poezia “Gruaja e poetit”. Në vargjet e kësaj poezie ai tregon sa e rëndësishme është poezia, madje për të është detyruar t’ia lë gjithë barrën e shtëpisë gruas së tij, që ai të ketë kohë të merret me krijimet e tij. Ai ndjen keqardhje për gruan e tij, pasi përveç poezisë, ajo zë një vend të rëndësishëm në jetën e tij, por gjithsesi nuk mund të heqë dorë prej krijimit të vargjeve. Gjithashtu ai në këtë poezi tregon se nuk është e lehtë të shkruash, si dhe duhet të përpiqesh shumë që lexuesi ta pëlqejë atë :

*“Ju thoni “s’ka figurka vjersha,*

*Ndaj poezia nuk të bind!”*

*Në doni thurni nja dy rreshta,*

*Për një statujkë në Butrint” (Agolli, 1998: 144)*

Ai në një farë mënyre sfidon të gjithë ata që kritikojnë poezinë e tij që të provojnë të shkruajnë për të parë se s’është aspak e lehtë të krijosh disa vargje të bukura. Vështirësia shtohet kur vendi në të cilin jeton nuk të frymëzon të shkruash poezi të bukura, kur nuk shikon asnjë shpresë për vendlindjen dhe duket sikur çdo gjë e ka mbuluar zymtësia. Këtë problematikë e trajton në poezinë “Vjersha e vrarë “ , “Në djall” e “Fara e poezisë”.

Autori i thyer shpirtërisht dhe i dëshpëruar për gjendjen në të cilën gjendje Shqipëria në kohën e tranzicionit nuk mund të shoh asgjë të bukur për ta paraqitur në poezitë e tij. Ai për një kohë të gjatë nuk gjen asnjë frymëzim, sepse ngado që hedh sytë vëren trishtim, qoftë në sytë e gruas së tij, qoftë në çantën e saj të pazarit të cilën përveç se me ushqime e ka mbushur me dhimbje e trishtim nga jashtë shtëpisë. Epiteti “vjershë e vrarë” nënkupton mungesën e frymëzimit, faktin që vjersha nuk mund të përfundohet, dhe vargjet “qëndrojnë në fletorkë” pa

u përfunduar. Te poeti ndërthuren ndjenjat e trishtimit, të dëshpërimit si dhe të keqardhjes edhe për gruan edhe për vjershën e lënë në gjysmë:

*Trupin tim me xhaketën e zbardhur shtyj si në gjumë*

*Një herë drejt vjershës, drejt gruas një herë*

*Një tango krejt për të qarë e s'di për cilën të qaj më shumë*

*Për vjershën e vrarë, a për gruan e mjerë?... (Agolli, 1998: 11)*

Ndonjëherë ai humbet vetëbesimin për të shkruar, sepse ndihet bosh dhe mendimet i ka të shterura. Këtë gjendje të tij shpirtërore e përshkruan në poezinë “Në djall” ku shprehet se sa të pamundur e ka që të nxjerrë një mendim. Duhet që të ndodhë diçka e madhe që autori të jetë i mbushur me mendime e frymëzim për të shkruar, ashtu siç e shpreh në mënyrë simbolike në këtë poezi :

*“Mbase duhet një gjëmë a tërmet shumë i madh*

*Që pusi të çahet, të shkojë në djall” (Agolli, 1998: 79)*

Por për çudi edhe në një gjendje të tillë poezia arrin të ngrejë kokën, të lulëzojë dhe poetët të krijojnë vargje aq të bukura në një vend të shkretë :

*“Në këtë vend nga iku dhe harabeli i shtëpisë*

*Ku luleshqerrat u thanë dhe humbi çdo flutur*

*Më thoni si mbiu farë e poezisë*

*Dhe doli kërcelli i saj i bukur” (Agolli, 1998: 206)*

Me anë të këtyre vargjeve autori do të tregojë forcën e poezisë. Në një vend të pashpresë poezia është vetë shpresa, në një vend ku nuk ka mbetur asgjë e bukur e është kapluar nga mjerimi, poezia është vetë bukuria dhe drita.

Dritëro Agolli është një autor i cili poezinë e tij nuk e shkruan nga apartamenti i tij, por ai kërkon për frymëzimin jashtë, në rrugë, në natyrë, në fusha e male. Përderisa Agolli ishte i bindur se poezia nuk krijohet me “këmbë në legen”, por “duke ecur”, tani na flet për dhimbjet e karvanit dhe psherëtimat e vjeshtës, për të vazhduar me vjershën “Lirikat e vjeshtës” ku u drejtohet lirikave me këto fjalë :

*“Tani jam rënduar s’ju ndjek dot në gurë*

*S’ju ndjek dot në këmbë, ju ndjek me veturë”* (Agolli, 1998: 99)

Autori gjithashtu beson se poeti dallon nga njerëzit tjerë. Edhe në bisedë me njerëzit mendja e tij shkon vetëm në botën e artit, te poetët e kohërave të vjetra si p.sh te Homeri. Poeti është një shpirt i lirë që bën gjëra të pamenduara nga njerëzit tjerë :

*“Ai për shembull rrëmbehet nga zjarri*

*Dhe flet me shpirtrat në erë”* (Agolli, 1998: 201)

Agolli është një poet që me plotë kuptimin e fjalës e ndjen poezinë, jeton për të, e quan pjesë shumë të rëndësishme të jetës së tij dhe jo më kot vetë poezinë e gjejmë në shumë krijime të tij si motiv.

## NDIKIMI I FILOZOFISË BEKTASHIANE NË VEPRËN “PELEGRINI I VONUAR”

Ndryshimet që ndodhën kohëve të fundit në Shqipëri, krijuesve u sollën mundësi që pikëpamjet e veta mbi probleme të ndryshme të artit, por dhe të jetës në tërësi t’i shprehin më hapur. Dritëro Agolli është një ndër autorët që aktualizon disa probleme, të cilat zgjojnë kureshtjen edhe të krijuesve tjerë. Në këtë përmbledhje me poezi ai do të fusë në brendi dhe disa krijime që flasin për një interesim të ri të tij. Një ndër krijimet e tilla është edhe poezia “Rubai” e cila na rikujton rubaitë e të famshmit Omar Khajam. Nga ky titull vërejmë lidhjen me botën orientale.

Meqenëse Dritëro Agolli vjen nga treva e Devollit, ku ndikimi i fesë dhe i filozofisë bektashiane ka qenë i fortë, mbetet që ky problem- problemi i ndikimit të kësaj filozofie në krijimtarinë e tij të thellohet në të ardhmen.

Naim Frashëri ka pasur ndikim të madh në krijimtarinë poetike të Dritëro Agollit. Përmenda këtë fakt jo rastësisht, por me qëllim që ta argumentojë interesimin e poetit për një filozofi e cila ishte përfaqëuar nga poetët e përmendur më sipër. Bektashizmi është një sekt i fesë islame, i cili panteizmin e ka botëkuptim, ndërsa tolerancën virtyt. Ndikimi i kësaj filozofie do të vërehet edhe në vjershat “Toka” , “Sipas Kuranit”, “Kujtime”, “Këngë më vete” etj.

Poezia “Toka” është një poezi e shkurtër në këtë përmbledhje që sipas shënimit të autorit në fillim të poezisë, është bazuar në librin e shenjtë Kuranin. Poezia është kjo :

*Kur toka të dridhet nga dhimbjet*

*Dhe barrën e saj ta nxjerrë*

*Dhe bota të thotë: “Çka kjo që dridhet”?*

*Ajo do të tregojë atëherë*

*Për veten e saj dhe për lindjet (Agolli,1998: 156)*



Kjo poezi është e qartë se është e përshkuar nga fryma fetare fillimisht nga shënimi i autorit që tregon se është bazuar në Kuran për këto vargje. Së dyti tematika e poezisë tregon praninë e fesë në këto vargje. Edhe pse Agolli mohonte fenë dhe deklaronte se ishte ateist, ai pjesë të veprave të tij bën edhe qëndrimet e tij për botën të mbështetura në gjykimin e librave fetarë. Në këtë drejtim ai flet edhe për gjithë atë që ka kjo botë, të cilat do të dalin në sipërfaqe atëherë kur ajo do të dridhet. Poezia “Sipas Kuranit” ka pak a shumë të njëjtën përmbajtje si kjo, pasi përcillet ajo që është e shkruar në librin e shenjtë islamik. I frymëzuar nga ky libër ai përsërit mënyrën e të shkruarit në Kuran, ku numëron të mirat që i ka falur Zoti njeriut, në formë të pyetjes, për të tërhequr kështu vëmendjen e lexuesit, si dhe për të rikujtuar besimtarin për të mirat që e rrethojnë.

Filozofinë bektashiane e vërejmë edhe në poezinë “Kujtime”. Në këtë poezi kemi përplasjen e dy brezave, dy ideologjive të ndryshme. Poeti si komunist që ishte kishte idhull Marks, kurse gjyshi i tij, besimtar i devotshëm, kishte idhull Haxhi Bektashin. Debati mes të dyve ishte i zjarrtë dhe që të dy “shanin” idhullin e tjetrit.

*Dhe të dy ne ishim besimtarë:*

*Gjysh dhe nip të krisur dhe të marrë*

*Gjyshi çirrte mjekrrën, nëmte Marks,*

*Unë i çmendur mbi Haxhi Bektashin!... (Agolli,1998: 106)*

Elementi bektashian është i pranishëm si në fillim ashtu dhe në fund të poezisë :

*Na dëgjonin katër qiparisë,*

*Duke tundur xhybet si dervishë. (Agolli,1998: 106)*

Dervishët janë udhëheqës ose mësues në sektin bektashian. Veshja e tyre është e veçantë me xhybe dhe çallmë ngjyrë të gjelbër. Pamjen e tyre të jashtme autori e krahason me qiparisët të cilët janë dëshmitarë të luftës së brezave, debatin mes një besimtari e një komunisti.

Poezia “Kujtimet” po ashtu na mëson më shumë për jetën e Agollit, më saktë për fëmijërinë e tij. Edhe pse ai është deklaruar si komunist e ateist, kjo poezi na tregon se familja e tij ishin bektashinj dhe autori ishte rritur në një ambient të tillë me një frymë të tillë fetare, por si i rritur vendosi të mos e praktikonte bektashizmin.

Konfliktin mes dy brezave e shpreh edhe në poezinë “Këngë më vete”. Në strofën e parë vërehet elementi bektashian ku autori krahason veten e tij me një dervish, që i ka kaluar jeta në udhëtim. Konflikti zhvillohet që në strofën e dytë ku autori në një farë mënyre përqesh gjyshin e tij që i lutej Zotit shumë që të nxjerrë në shesh të vërtetën. Por autori vetë shprehet mospërfillës për lutjet e tij, sepse në bazë të asaj që shikonte nuk besonte që Zoti po i ndihmonte disi:

*“Zoti hante buk e dhallë*

*Shpata priste gjethe*

*E vërteta ish e çalë*

*Trimëria në ethe” (Agolli,1998: 181)*

Meqë jemi te bektashizmi, mund të ndalemi pak më gjerësisht te elementët fetarë në përgjithësi në përmbledhjen poetike “Pelegri i vonuar”. Adami dhe Eva janë personazhë fetarë që përmendën në disa poezi, edhe atë : “Vështrim pas gjurmëve”, “Frutat e Adamit”, ku flitet për ardhjen e tyre në këtë botë, mëkatet e tyre të para, të cilat autori i krahason me mëkatet e tij gjë që e ngushëllon atë herë pas here.

Objektet fetare po ashtu përmenden në vargjet e këtij vëllimi. Poezia “Kishat e shembura” është njëra prej tyre. Në këtë poezi autori flet për mohimin e Zotit nga njerëzit, të cilët në formë proteste si dhe për të treguar se nuk i duan më perënditë shembin kishat e xhamitë. Shembja e objekteve fetare tregon shembjen e besimit. Edhe pse vetë autori nuk i besonte, në këtë poezi tregon Zotin e plotfuqishëm, që i reziston shembjes, dhe arrin të ngrëjë zërin edhe ndër gjëmadha.

*“Dhe thoshte: “Mosni o njerëz,*

*Se guri do të jetë më i rëndë,*

*Kur kishat t'i ngrini sërishmi nesër* (Agolli, 1998: 27)

Ndoshta edhe ndikimi i regjimit komunist që mohonte ekzistencën e Zotit, bëri që Dritëro Agolli të zgjedhë atë rrugë, të mos besojë në Zot. Por edhe pse në intervista të ndryshme ai e shpreh haptas këtë mendim, në poezi shprehet ndryshe. Ai shpesh i lutet Zotit, e kërkon falje prej tij. Këtë gjë e hasim në poezinë “Perëndisë” ku e bren ndërgjegjja sepse ka gënjyer një vajzë në rininë e tij. Në vargjet e kësaj poezie ai shpreh konfliktin brenda vetes së tij: nuk beson në Zot, por i kërkon falje.

*O Perëndi e sfilatur me jetën*

*Nga unë, që ty s'të besoj*

*Prano, të lutem, të falur!* (Agolli, 1998: 52)

Këtë fenomen e vërejmë edhe në poezinë “Lutja e të çmendurve”, ku i lutet Zotit që ti falë ata që atij i duan të keqen e që luten që atij ti ndodhë diçka e keqe.

Diçka që e lidh poetin me Perëndinë është edhe vdekja. “Fluturat e varrezave” është një poezi ku kemi motiv vdekjen. Vdekja dhe varrezat i rikujtojnë poetit Zotin gjë që e shpreh në këto vargje :

*“Pa dashur më sjellin në mend Perëndinë*

*Edhe pse jam lugat ateist”* (Agolli, 1998: 118)

Këto janë vargjet ku autori në mënyrë të drejtpërdrejtë shpreh mendimin e tij mbi ekzistencën e Zotit si dhe për bindjet e tij fetare. Gjithsesi vdekjen e Perëndinë i sheh si dy gjëra mjaft të lidhura me njëra-tjetrën ndaj nuk mund ta largojë mendimin për të sa herë që viziton varrezat.

Por pse ky qëndrim i Agollit? Nga ajo që ka parë në jetë, ai beson se ka njerëz që mund ti luten Zotit, por ai nuk është dakord me shumë njerëz që bëjnë vepra të këqija dhe luten vetëm në sy të njerëzve. Këtë gjë e tregon në poezinë “E drejta për tu falur”

*“Njeriu i lodhur ka ndofta të drejtë*

*Të falet te Zoti*

*Të tjerët, tinëzarë e ujqër të vjetër*

*I falen së koti” (Agolli,1998: 190)*

## STRUKTURA RITMIKO – INTONATIVE

Poezia është gjetja e harmonisë apo vendosja e harmonisë së sendeve, ndjenjave e mendimeve, prandaj edhe poeti quhet bir i harmonisë, thekson vetë poeti Dritëro Agolli në pasthënien e vëllimit "Pelegri i vonuar". Harmonia për të cilën flet poeti me poezinë e tij arrihet me zgjedhjen e tingujve:

*"Shumë ujë gri, shumë qiej gri*

*Gri në dritare, gri në vetmi..."* (Agolli, 1998: 13)

me zgjedhjen, radhitjen dhe kombinimin e fjalëve, të cilat i ngarkon jo vetëm me funksionin kuptimor -semantik, por edhe me vlera muzikore e melodike:

*"Ankime nga miqtë, ankime nga rruga*

*Ankime nga gruaja ime*

*Veriu fishkëllon, ngre pluhurin juga*

*Ankime, ankime, ankime"* (Agolli, 1998: 34)

Organizimi i vargut në vjershat e këtij vëllimi është i çuditshëm, prandaj me të drejtë Moikom Zeqo do të shkruajë: *Te asnjë poet shqiptar i traditës dhe i sotëm, unë nuk kam mundur të gjej një teknikë të tillë të çuditshme e të pangjashme të ritmit të brendshëm të poezisë si të Dritëroit, ku strofa e parë është shembull, dhjetërrokëshe, e dytë dymbëdhjetë, e treta gjashtë, ose brenda për brenda strofës, numri i rrokjeve është paradoksalisht jo i njëjtë dhe pavarësisht nga ky trill e tërë poezia e tij është ritmike dhe artistikisht tingullore (MOIKOM ZEQQO, ART. CIT)*

*"Dhe kur njeriu nuk ndien më as mall as dhëmbje*

*nuk ndien as gaz as hidhërim as shpresë*

*një gjë ju them me ndershmëri dhe bindje*

*lëreni të vdesë"* (Agolli, 1998: 100)

Strofa më e përdorur në këtë poezi është strofa katërshe, që është edhe strofa më e përhapur në poezinë shqipe, por edhe në letërsinë tjera evropiane, por ka edhe strofa pesëshe, dyshe, treshe etj. Gjithsesi, Dritëro Agolli ka eksperimentuar me të gjitha llojet e vargjeve duke filluar nga më të shkurtët, pra vargjet trerrokëshe, e për të përfunduar me vargjet më të gjata, gjashtëmbëdhjetërokëshe. Kjo gjë na bën të kuptojmë aftësinë e tij si krijues i rrallë që di të përdorë të gjitha këto forma vargore edhe atë me shumë sukses, duke i dhuruar lexuesit një poezi shumë të bukur për ta lexuar, nga ana ritmike e melodioze, pa lënë anash edhe aspektin kuptimor.

Në vargun agollian ndihet shumë ndikimi i letërsisë popullore si dhe i autorëve të Rilindjes Kombëtare. Ai ka marrë nga kjo letërsi elementet më të vlefshme të asaj tradite poetike, duke i përfshirë në krijimet e tij por në një mënyrë shumë origjinale. Struktura ritmike e poezive të Dritëro Agollit, ngjason shumë me lirikat popullore si dhe vërehet në vargjet e Lasgush Poradecit, Naim Frashërit si dhe të Ndre Mjedës.

Për sa i përket vargjeve, Agolli është një autor i cili parapëlqen vargun e rregullt por nuk lë pas edhe vargun e lirë të cilin e hasim në disa prej poezive të tij. Duke lexuar poezitë në vëllimin poetik "Pelegri i vonuar" vërejmë se Dritëro Agolli është një autor i cili ka përdorur rimën në krijimet e tij. Të rralla janë poezitë ku vargjet nuk përputhen njëra me tjetrën. Ai ka eksperimentuar me llojet e ndryshme të rimave varësisht nga numri i vargjeve, e strofave në poezitë e tij.

Nëse duam të paraqesim rimën e strofave të ndryshme të poezive në këtë përmbledhje poetike, ajo do të dukej kështu :

1. strofa katërshe : (ABAB), (AAAA)

*-“Ankime nga miqtë, ankime nga rruga*

*Ankime nga gruaja ime*

*Veriu fshikullon, ngre pluhurin juga:*

*Ankime, ankime ankime” (Agolli, 1998: 34)*

*-“Hesht pas dritares maçoku i zi*

*Gazeta hapet me tituj gri*  
*Gri në dritare, gri në vetmi,*  
*Ikin lejlekët larg në arrati...*(Agolli, 1998: 13)

2. strofa dyshe : (AA)

*“Më lodhi mundimi në shpirt tërë jetën*  
*Ta them lakuriq të vërtetën”* (Agolli, 1998: 25)

3. strofa treshe : (ABA)

*“I shembëm kishat e xhamitë,*  
*E mburrëm shëmbjen me zjarr e hekur*  
*Dhe thamë: u shporrën nga ne perënditë!”* (Agolli, 1998: 27)

Një tjetër veçanti e Dritëro Agollit është se ai për të përshtatur rimën në disa raste përdor fjalë të huazuara nga gjuhë të huaja, të cilat në fakt nuk janë barbarizma që përdoren shpesh në gjuhën tonë. Shembull konkret kemi poemën “Trëndafilat e turkeshës” në të cilën ai përdor shumë turqizma për të përshtatur rimën si dhe për ti arritur efektin e duhur te lexuesi, pra për ta thelluar atë më mirë në ngjarjen që ndodh në poemë. Shembull:

*“Katër turq, turkesha pesë, me raki, turshi e mish*

*Yzmetçi Kasëm Murati na zgjat dorën për bakshish”* (Agolli, 1998: 168)

Vërejmë se vargu agollian përshkohet nga muzikaliteti. Çdo varg i tij ka një ritëm të këndshëm që dallohet qartë gjatë leximit. Loja e fjalëve, rimat si dhe huazimet që përdor e bëjnë poezinë e tij shumë tërheqëse për ta lexuar.

Është fjalori poetik të cilin e përdor Dritëro Agolli që luan një rol shumë të rëndësishëm në muzikalitetin e poezive të tij. Lidhja që ai u bën fjalëve përcjell emocionin si dhe idenë e autorit te lexuesit.

Përsëritja e tingujve është shumë e pranishme në poezinë e Agollit. Ajo jo vetëm shton melodicitetin vargjeve por ndikon edhe nga ana kuptimore. Asonanca dhe aliteracioni janë figurat të diksionit që i gjejmë shpesh në poezitë e këtij autori, ku e para nënkupton përsëritjen e zanoreve, kurse e dytë të bashkëtingëlloreve. *Te këto figura arrihet një efekt i caktuar emocional dhe përmes tingëllimit, përmes zëshmërisë së këndshme dhe harmonike- eufonisë.* (Aliu, 1986: 75) Sidomos aliteracioni është figura e përdorur prej tij që i jep efektin ritmik poezisë.

Poezia e Dritëro Agollit është polistrofike, isoritmike e heteroritmike. (Sinani, 2012: 18)

## STRUKTURA FIGURATIVE

Kur kemi dhënë disa mendime për poezinë e Dritëro Agollit kemi vlerësuar se poezia e tij është e drejtpërdrejtë dhe mjaft komunikative. Me këtë nuk kemi dashur të mohojmë aftësitë e poetit për të shfaqur përjetimet dhe frymëzimet e veta përmes figurave të zgjedhura, nuk kemi dashur të mohojmë mjeshtërinë e konkretizimit vizuel e figurativ të botës poetike të Dritëro Agollit, përkundrazi do të theksojmë me këtë rast mjeshtërinë e vënies në veprim të një sistemi të tërë figurash që shkojnë e inkuadrohen në tërësinë e krijimit poetik, si një natyrshmëri e domosdoshmëri, varësisht nga temat, motivet, nga perceptimi dhe qëndrimi i poetit ndaj objektit poetik. Në konstituimin e strukturës figurative dhe ritmike të vëllimit “Pelegri i vonuar” marrin pjesë figurat e mendimit : krahasimi, antiteza, ironia etj., figurat e fjalëve: metafora, personifikimi, epiteti, simboli etj, si dhe figurat e diksionit: asonanca dhe aliteracioni.

Krahasimi është njëra nga figurat më të shpeshta të poezive të këtij vëllimi. Krahasimeve që ngapak duken të vjetruara, por që hyjnë logjikshëm në brendinë e krijimit poetik si p.sh e thatë si drizë, thahen si kashtë etj. ,do të gjejmë edhe krahasime të reja dhe mjaft të suksesshme që zgjojnë asociacione të ndryshme te lexuesit, p.sh. Ankthin që ndjen në shpirt poeti, në vjershën “Pritja” do ta krahasojë me iriqin, qepën në vjershën “Qepa” me një balerinë, kallinjtë e grurit me krahët e vajzave lakuriq, tek vjersha “Fusha me grurë”, krevatin e



zbrazur e krahason me një tabut për njeriun e vdekur tek “Vdiq një njeri i vetmuar”, ose në poezinë “Klithma e shpirtit” burri hap gojën si një midhje etj.

Femra zë një vend të rëndësishëm në poezinë e Dritëro Agollit, e shumë shpesh në poezitë e tij vërejmë krahasime të ndryshme për karakteristikat e femrës. Në poezinë “Dëshira” autori përshkruan bukurinë e trupit të saj me anë të krahasimeve p.sh krahason buzët e saj me dy qershi të lëngshme. Edhe në poezinë “Qetësi e bukur” ku shpreh dashurinë dhe mirënjohjen për bashkëshorten e tij, ai na paraqet figurën e saj me anë të krahasimit. Do të shënoj disa vargje ku kemi figurën e krahasimit:

*“Flenë buzët e saj si kokrra e prerë në mes e qershisë*

*Flenë qerpikët si halat natën në grurë*

...

*Dhe nën ballë vetullat si krah dallëndyshe heshtin “ (Agolli, 1998: 96)*

Në poemën “Trëndafilat e turkeshës”, autori krahason trupin e femrës, të turkeshës në këtë rast me tespitë. Ai bën një krahasim shumë të arrirë, duke dashur të tregojnë butësinë dhe sa e lëmuar është ajo. Kokrrat e tespihëve janë të lëmuara nga sedefi ose qelibari, por njëkohësisht lidhen edhe me besimin fetar. Në Turqi dimë se shumica i përkasin besimit islam, prandaj autori jo vetëm bën krahasimin e trupit të femrës, por edhe e përshtat atë me ambientin turk në të cilin gjenden heronjtë lirikë të poezisë. Edhe në vargje të tjera të kësaj poeme gjejmë krahasime për të treguar bukurinë e turkeshës. Sytë e saj poeti i krahason me gurët e xhevahirit, pra do të tregojë që janë të bukur dhe të shndritshëm.

Në poezitë e Agollit gjejmë shpesh edhe krahasime për hapësirën që na rrethon, për natyrën, për fenomenet e dukuritë e saj. Në poezinë “Natën larg teje” autori krahason qiellin me një “tepsi të kallaisur” kurse lumin e krahason me një mëz “të hazdisur”. Në poezinë “Nuk na mërziten” ai krahason retë e bardha që mbulojnë botën me një jorgan e një pëlhurë. Dimri është një stinë që karakterizohet nga e bardha, për këtë arsye autori e krahason me një patok të bardhë që zbret dalëngadalë nga mali.

Rikthehemi përsëri te poema “Trëndafilat e turkeshës” ku autori duke dashur të përshkruajë detin Marmara, e krahason atë me çallmën e sulltanit. Kështu jo vetëm që tregon një karakteristikë të detit, por edhe e lidh atë me historinë e vendit.

Nata gjithmonë na jep një ndjesi ndryshe, gjatë natës njerëzit janë më të qetë, më të heshtur, nuk e kanë gjallërinë e ditës. Për këtë arsye në poezinë “Lemza” autori krahason natën me një vejushë të braktisur e të pashpresë. Ky krahasim lidhet me faktin që errësira që kaplon natën botën, lidhet ngushtë me errësirën e shpirtit, e vetmisë dhe trishtimit. Pikërisht një vejushë që ka humbur njeriun e jetës ndihet në mënyrë të tillë.

Në poezinë “Të kërrusur në udhë” autori duke dashur të tregojë vështirësitë, përjetimet e njeriut gjatë jetës së tij dhe shenjave që lënë ato, bën një krahasim shumë të arrirë duke vënë përballë rrudhat në fytyrën e një plakut me vijat një shkëmbi të gërryer nga përrenjtë.

*“Jemi rrudhur fytyrash siç rrudhen shkëmbenjtë*

*Kanë kaluar në rrudhat tona përrenjtë” (Agolli, 1998: 49)*

Fjalët e vargjet janë shpesh të krahasuara në poezitë e Agollit. Vargjet e tij autori i krahason me ujin. Fjalët dhe mendimet e tij pra gurgullojnë si uji, por për fat të keq vjen momenti që edhe vaken si ai.

Fjalën autori e krahason edhe me dallëndyshen, e cila ashtu si fjala fluturon e largohet sapo ka dalë nga foleja.

*“Kur fjala nxirret nga buzët jashtë*

*Si dallëndyshe s’vjen në shtëpi” (Agolli, 1998: 65)*

Krahasimi më i arritur sipas mendimit tim në këtë vëllim është ai që i bën zemrës, ku e krahason me një shtëpi, në poezinë “Në zemër”. Nëse e mendojmë më thellë kuptojmë se zemra është vërtet një shtëpi, ku jetojnë të gjitha ndjenjat tona si dashuria ashtu dhe trishtimi, si malli e zhgënjimi. Për ta parë më mirë këtë krahasim le të lexojmë vargjet e strofës së parë:

*“Zemra i ngjan një shtëpie*

*Ka dhomat e saj me pije e kikirikë*

*Sallonë malli e mërzie*

*Diskoteka me valle e muzikë” (Agolli, 1998: 139)*

Trishtimin që ka zënë vend në zemrën e poetit, e krahason me iriqin. Me anë të këtij krahasimi kuptojmë se kjo ndjesi që ka kapluar autorin, e ngacmon atë si një iriq që mund të të shpojë me gjembat e tij për mos të të lënë të qetë, ashtu siç edhe trishtimi nuk e lejon poetin të jetojë i lumtur.

Personifikimi- po ashtu është njëra nga figurat më të përhapura në veprën “Pelegrini i vonuar” . *Personifikimi është një lloj i posaçëm i metaforës në të cilën gjërave, dukurive, sendeve abstrakte, kafshëve ose bimëve u jepen cilësi njerëzish (Solar, 1976: 87).* Kështu për shembull qepa flet me poetin, çezma fle me sqep në lavaman, hëna përgjon, çizmet mërziten, këpucët zbaviten, bushtra shan, oxhaku vjell etj. këto janë disa nga personifikimet që përdoren në këtë vëllim të Dritëro Agollit.

Në poezinë “Në fund të vjeshtës” autori i jep karakteristikat e një plaku erës. Personifikimin e vërejmë që në vargjet e para të poezisë :

*“Me bastun bre dh era qorre*

*Zbret në lum e shkon në varre” (Agolli, 1998: 73)*

Lëvizjen e thjeshtë të erës që në sytë tonë duket aq e thjeshtë, autori e zbukuron aq shumë, sa të jep përshtypjen se ajo është e gjallë, se i ngjason një plaku i cili ec me bastun. Edhe në poezinë “Pas punës” kemi përsëri erën e cila vepron si një njeri duke përkëdhelur “rrudhat e arës së vakët”.

Në poezinë “Rruga e lagur” kemi personifikimin e reve, yjeve e plepave. Autori u jep atyre karakteristikat njerëzore duke treguar veprimet e tyre :

*“Plepat rrugës ia hodhën kapotën*

*Qajnë yjet mbi trupin e saj” (Agolli, 1998: 104)*

Një mjeshtri e autorit është përshkrimi i peizazhit me anë të personifikimit. Ai përshkruan pamjen e plepave ose takimin e ujit me tokën me anë të personifikimit duke u dhënë karakteristika njerëzore. Këtë gjë mund ta vërejmë në tre poezi. Poezia e parë është “Nuk na mërzhiten” ku për të përshkruar lumin dhe gurët autori shprehet :

*“Dhe lumi që lëpin gurët e zallit” (Agolli, 1998: 196)*

Ndërkohë në një poezi tjetër përshkruan se si plepat janë veshur me pallto të gjelbra sikur njerëzit, duke dashur kështu të tregojë pamjen e tyre të gjelbëruar.

Një poezi ku autori bën një personifikim aq të arrirë është “Trëndafilat e turkeshës”, ku në pjesën e tretë të kësaj poeme, duke dashur të përshkruajë pamjen e Stambollit, pamjen e bukur të takimit të detit me bregun, ai shprehet :

*“Në Xhenet Bahçe” turkeshat kush si do, kush si pëlqen?*

*Marmaraja xha Stambollit ia lan këmbët në legen. (Agolli, 1998: 169)*

Për të përshkruar madhësinë e Stambollit, që është një qytet i vjetër por edhe shumë i madh e konsideron si një njeri kur e quan “xhaxha”, ndaj deti Marmara e “nderon” duke i larë këmbët me ujin e tij.

Një përhapje të gjerë në poezitë e këtij vëllimi ka edhe anafora (*nga gr.- anaphora, të shtruarit, përsëritje*) do të thotë *përsëritje fjalësh në fillim të vargjeve (Solar, 1976: 82):*

*Po ai sënduk i drunjtë me letër ngjitur*

*Po ajo vazo e vockël me lule zëmbaku*

*Po ai mulli kafeje me mbulesë të grisur*

*Po ato tespihe-kujtim i vjetër nga plaku (Agolli, 1998: 50)*

Poezi të tjera ku gjejmë anaforë janë edhe “Ankimet”, “Ç’të bësh”, “Tani më duhet të mësoj”, “Qetësia e bukur”:

*“Ankime nga miqtë ankime nga rruga,*

*Ankime nga gruaja ime” (Agolli, 1998: 34)*

*“Ç’të bësh kur s’të flihet*

*Ç’të bësh kur je vetëm, me cilin të zihesh*

*Me cilin të rrihesh?” (Agolli, 1998: 47)*

Edhe në dy strofat tjera të poezisë, kemi fillimin e njëjtë të vargut, kurse ndryshon vetëm vargu i tretë.

*“Mësova të pi sisë e të ngrihem në këmbë,*

*Mësova të bëhem i ri dhe i vjetër*

*Mësova të plakem, të heq e të vë dhëmbë” (Agolli, 1998: 64)*

Poezia “Qetësi e bukur” është njëra nga poezitë ku gjejmë më shpesh anaforën, pothuajse në të gjitha strofat e saj. Do të paraqes dy raste nga kjo poezi, ku gjendet anafora :

1. *“Flenë sytë e saj që më mahnitën vite me radhë,  
Flenë buzët e saj si kokrra e prerë në mes e qershisë  
Flenë qerpikët si halat natën në grurë  
Flenë mollëzat e faqeve që bëjnë gropëza kur qeshin” (Agolli, 1998: 98)*
2. *“Të kam lënë fëmijë e shqetësime mbi shpinë  
Të kam lënë pazarin, radhën e netët fillikate  
Të kam lënë mbi shpatulla gjithë shtëpinë.” (Agolli, 1998: 98)*

Poezia të tjera ku kemi figurën e anaforës janë : “Rëndësia” (fq. 153), “Syri i djeshëm” (fq. 136), “Njerëzit” (fq. 110), “Këngë djepi” (fq. 56), “Ndarja” (fq.23).

Në vargjet e këtij vëllimi haset edhe epifora, që ka të bëjë me përsëritjen e fjalëve në fund të vargjeve. Këtë figurë e gjejmë më rrallë në këtë vëllim poetik, edhe atë në vetëm dy poezi :  
“Mos ma kujto” dhe “Qetësia”

*“E shkuara ka orë e çaste të hidhura, mos ma kujto*

*Ka drojtje dhe heshtje, kur lipsen të thirrura, mos ma kujto” (Agolli, 1998: 18)*

*“Nata s’dëgjohet kur zbret nëpër male, zbret qetësisht*

*Jeta s’dëgjohet kur humb dalngadalë, humb qetësisht” (Agolli, 1998: 102)*

Përsëritja është një figurë që është shumë e pranishme në poezi, por siç mund të kemi përsëritje të fjalëve, në fillim ose fund të vargut, mund të kemi edhe përsëritje të gjithë vargut disa herë brenda poezisë. Te poezia “Kujdes me fjalën” vërejmë përsëritjen e dy vargjeve të njëjta në të gjitha strofat e poezisë :

*“Kujdes me fjalën, zonjës me çantë*

*Kujdes me fjalën dhe ti zotëri” (Agolli, 1998: 65)*

Përsëritjen e vargut e gjejmë edhe të poezia “Poçari”, ku poeti në fund të çdo strofe përsërit njërin prej vargjeve të strofës, për ta theksuar më mirë mendimin e ti, për shembull në strofën e parë kemi :

*“Vajta në Stamboll të bëj Pazar*

*Për kujtim ta ble një vazo balte:*

*-Paqe dhe selam usta poçar*

*Vazon më të mirë, po e pate,*

*Paqe dhe selam usta poçar! “ (Agolli, 1998: 164)*

## PËRFUNDIM

Dritëro Agolli është njëri nga autorët më me rëndësi në gjithë letërsinë shqipe mund të themi, duke filluar nga vitet 1960 atëherë kur u shfaq në botën letrare shqiptare, duke bërë ndryshime rrënjësore si në aspektin stilistik ashtu edhe në atë kuptimor të poezisë shqipe. Me veprat e tij, sidomos ato poetiket ai e ka pasuruar shumë letërsinë shqipe si dhe e ka ngritur atë në pedestale të larta. Ai krijimtarinë e tij letrare e filloi para më se tre dekadave dhe vëllimi që kemi në shqyrtim shënon një jubile të autorit: 25 vjetorin e botimit të veprës së tij të parë me poezi. Robert Elsie, përkthyes dhe studiues i njohur i letërsisë shqiptare në një recension për librin “Pelegri i vonuar” të botuar në revistën e njohur amerikane WORLD LITERATURE TODAY do të pyesë: A nuk qenkan ngopur lexuesit me Dritëro Agollin, që ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të kontrolluar nga partia për periudhën nga spastrimi i liberalëve më 1973 e deri në fundin e diktaturës më 1990, dhe që ishte kreu e qendra e vëmendjes e sistemit zyrtar të funksionimit të letërsisë së Shqipërisë komuniste, për më tepër, që është bërë edhe politikan drejtues i Partisë Socialiste në opozitë sot? Dhe më tutje vazhdon: Jo, e vërteta është se lexuesit nuk janë ngopur me Dritëro Agollin dhe ende presin prej tij. (Gazeta Rilindja, 26.10. 1994)

Dritëro Agolli dallohet jo vetëm si autor i veçantë, por edhe si një personalitet i tillë.

“Pelegri i vonuar” është njëra ndër veprat e para të botuara pas ndryshimit të sistemit shoqëror në Shqipëri dhe për mënyrën e qasjes së problemeve dhe trajtimit të tyre artistik paraqitet interesante jo vetëm për kulturën shqiptare, por edhe atë të popujve tjerë që pak a shumë jetonin në rrethana të njëjta.

Në këtë punim është tentuar të nxirren disa vlera të këtij vëllimi, i cili nga disa studiues vlerësohet si një nga librat më të bukur lirikë të letërsisë shqipe. Është tentuar të paraqitet gjerësia tematike dhe ideore e poezive të këtij vëllimi, por edhe vlerat figurative dhe ritmiko-intonative të tij, edhe pse është gati e pamundur të bëhet kjo, pasi është vështirë të përfshihet tërë ajo botë lirike që sjell, përjeton dhe shtjellon poeti ynë.

## BIBLIOGRAFIA

1. “Maja e çelur- Antologji e letërsisë bashkëkohore shqiptare”, Shtëpia botuese e Librit Shkollor, Tiranë, 1994
2. Agolli, Dritëro, “Pelegri i vonuar”, Shtëpia botuese “Dritëro”, Tiranë, 1998
3. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës “Rrjedhat e letërsisë bashkëkohore shqiptare”, Prishtinë, 2005
4. Aliu Ali, “Don Kishoti shqiptar”, Tiranë, 2010
5. Aliu Ali, “Letërsia bashkëkohore shqiptare”, Tiranë, 2001
6. Aliu Ali, “Teoria e letërsisë”, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, Prishtinë, 1986
7. Bexheti Vebi, “Mrekullia e fjalës poetike”, Interlingua, Tetovë, 2014
8. Bexheti Vebi, “Trajtesa letrare”, Arbëria Design, Tetovë, 2012
9. Bihiku Koço. Me zemër në dorë para lexuesit: Pelegri i vonuar. 24 orë, 27 nëntor, 1994, fq. 5
10. Bullo Jorgo, “Magjia dhe magjistarët e fjalës”, Tiranë, 1998
11. Dado Floresha, “Intuitë dhe vetëdije kritike”, Tiranë, 2006
12. Dado Floresha, “Letërsia e painterpretuar”, Tiranë, 2010
13. Dritëro Agolli, personalitet i shquar i letërsisë dhe kulturës shqiptare, Gjirokastër, 2013
14. Elsie Robert, “Histori e letërsisë shqiptare”, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 406-418
15. Gazeta Rilindja, 26.10. 1994, Prishtinë
16. Osdautaj Murteza, “Aspekte të poetikës së Dritëro Agollit”, Sh. B. Faik Konica, Prishtinë, 2011
17. Selmani Ahmet, “Diskurs kritik”, Tetovë, 2005
18. Selmani Ahmet, Rishikimi poetik: Pelegri i vonuar, Në : A. Selmani, “Poezia dhe individualiteti”, Shkup, 1996, fq. 27-37
19. Sinani Shaban dhe autorë të tjerë, “Letërsisë bashkëkohore shqiptare (pas Luftës së Dytë Botërore), Sh. b. Albas, Tiranë, 2002



20. Sinani Shaban, "Njerëzit e krisur të Dritëro Agollit", Sh.b. Naim Frashëri, Tiranë, 2012
21. Sinani Shaban, "Për letërsinë shqipe të shekullit të XX-të", Tiranë, 2008
22. Solar Milivoj, "Teoria e letërsisë", Rilindja, Prishtinë, 1976, fq. 87
23. Shaplllo Dalan, "Poezia nëpër kohë", Sh.b. Naim Frashëri, 1990
24. Vinca Agim, "Fije të pakëputura", Pro kultura, Shkup, 2004
25. Vinca Agim, "Struktura e zhvillimit të poezisë së sotme shqipe (1945-1980), RILINDJA, Prishtinë, 1985
26. Vinca Agim, "Orët e poezisë", botimi i dytë, AAB RIINVEST, Prishtinë, 2010
27. Xhaferi Hamit, "Çështje letrare", Interlingua, Shkup, 2014, fq. 199
28. Zisi Roland, "Antologji poetike për kuajt", Shtëpia botuese "NAIMI", Tiranë, 2014
29. Zisi Roland, "Letërsia bashkëkohore shqipe- poezia", Tiranë, 2008
30. Zunçe Valbona, "Antologjia e lirikës shqipe", Shtëpia e artistëve "Pushkin", Tetovë, 2008